



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.654/7 prot.

Datë 09.04.2026

V E N D I M
Nr. 490/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.04.2026 u shqyrtua ankesa me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “MUHOPLUS” LTD në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-67300-10-30-2025, me objekt: “*Furnizim me makineri shtypshkrimi*”, me fond limit 19 760 000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.01.2025 nga autoriteti kontraktor, Shtypshkronja e Letrave me Vlerë sh.a.

Autoriteti Kontraktor: Shtypshkronja e Letrave me Vlerë sh.a, me adresë: Rruga “Xhanfize Keko”, ish-Tipografia Ushtarake, Tiranë

Ankimues: Operatori ekonomik “4E-COLOR” SHPK, me NUIS K21505002B, me adresë: Rruga Ali Demi, ish Kombinati Poligrafik, Magazine Nr.Pasurise 6/232, ZK.8180, Tirane

Subjekte të Interesuar: Operatori ekonomik “MUHOPLUS” LTD, me NUIS L52317046G, me adresë: Njësia Bashkiake Nr.7, Rruga Ded Gjo Luli, Pallati Nr.2, Shkalla 2, Ap.4, Tiranë.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi Paraprak*

- I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.
- I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.
- I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.
- I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

- II.1. Në datën 31.10.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-67300-10-30-2025, me objekt: “Furnizim me makineri shtypshkrimi”, me fond limit 19 760 000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.01.2025 nga autoriteti kontraktor, Shtypshkronja e Letrave me Vlerë sh.a.
- II.2. Në datën 29.01.2026 autoriteti kontraktor ka përfunduar fazën e vlerësimit të ofertave. Ofertuesit janë njoftuar elektronikisht si vijon:

1. “MUHOPLUS” LTD ” SHPK 13 800 000 lekë, kualifikuar
2. “4E-COLOR” SHPK 15 796 000 lekë, kualifikuar

II.3. Në datën 19.02.2026 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit të procedurës së prokurimit në SPE.

II.4. Në datën 02.03.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6374 dhe nr. 654/2026 protokoli, datë 02.03.2026 e operatorit ekonomik “4E-COLOR” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-67300-10-30-2025, me objekt: “Furnizim me makineri shtypshkrimi”, me fond limit 19 760 000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.01.2025 nga autoriteti kontraktor, Shtypshkronja e Letrave me Vlerë sh.a.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “MUHOPLUS” LTD në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Konkretisht pretendohet si vijon:

“Para se gjithash ne jemi shume te befasuar me kualifikimin e Operatorit ekonomik MUHOPLUS Ltd shpk Tirane per faktin se ky O.E ne aktivitetin e tij nuk ka asnje lidhje me fushen e industrise poligrafike.

Ne 23 vite pune te kompanise sone, asnjehere nuk e kemi hasur subjektin MUHOPLUS Ltd shpk Tirane, si konkurent apo si furnitor ne tregun privat dhe entet shteterore.

Theksojme se tregu i industrise poligrafike per shtypshkronjat eshte nje treg specifik dhe me vecori karakteristike qe kerkon eksperience dhe fushë veprimtarie te mirepercaktuar.

Ky O.E nuk disponon asnjë nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshatshme apo nga kontratat e zbatuara në të shkuarën, sikurse percaktohet ne Nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020.

Operatori ekonomik MUHOPLUS Ltd shpk Tirane eshte nje subjekt qe operon ne fushen e ndertimeve, ne fushen e ujesjellesave dhe kanalizimeve, ne fushen e hidrocentraleve, apo ne fushen e transmetimeve elektrike, por nga referencat apo nga kontratat e zbatuara në të shkuarën ne asnje rast nuk kemi te bejme me kontrata te realizuara ne fushen e importit dhe tregetit te makinerive te shtypit, pjeseve te kembimit per makinerite e shtypit, furnizimin me lende te pare te industrise se shtypit, mirembajtje dhe servisim te makinerive te shtypit.

Megjithese operatorit ekonomik MUHOPLUS Ltd shpk Tirane nuk ploteson kriteret e dhena ne DST, Komisioni i Vleresimit te Ofertave te autoriteti kontraktor, Shtypshkronja e Letrave me Vlerë sha ne kundërshtim te hapur me klauzolat e Ligjit nr. 162/2020, e ka kualifikuar dhe ka publikuar njoftimin paraprak te fituesit.

Ne vazhdim ne do te argumentojme fakte dhe argumenta konkrete per gabimet e KVO ne vleresimin dhe kualifikimin e ofertes se operatorit ekonomik MUHOPLUS Ltd shpk Tirane.

I.

Se pari dhe ajo qe eshte me kryesorja, rezulton se O.E MUHOPLUS Ltd shpk nuk ka Kapacitetin Teknik dhe Profesional per te realizuar kete kontrate sepse nuk permbush kriterin kualifikues, per realizimin gjatë 3 (tre) viteve të fundit te furnizimeve të ngjashme per makinerite e shtypit.

Operatori ekonomik MUHOPLUS Ltd shpk Tirane gjate 3(tre) viteve te fundit te aktivitetit te tij ne periudhen 2023 2024 2025, nuk ka realizuar asnje kontrate te ngjashme me makinerite e shtypit te kerkuara ne tender.

Ne kriteret e vecanta te kualifikimit te DST eshte kerkuar që : - O.E ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se 40% e vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë;

a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga A.K ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara,

b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Pra eshte kerkuar qe brenda viteve 2023 2024 2025 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar furnizime të ngjashme me makineri shtypi në një vlerë jo më të ulët se 40% e fondit limit ose ne vlere absolute ne shumen prej jo me pak se 7.904.000 leke pa TVSH.

Ne lidhje me plotësimin e kriterit kualifikues per kryerjen gjatë 3 (tre) viteve të fundit te furnizimeve të ngjashme per makinerite e shtypit nga O.E MUHOPLUS Ltd shpk Tirane, ne disponojme te dhenat zyrtare te shpallura ne Buletinin e Prokurimeve Publike te publikuar ne sistemin e prokurimit elektronik, ku jane te evidentuara te gjitha kontratat qe subjektet kane realizuar ne entet shteterore per periudhen e viteve 2023 2024 2025.

Nga verifikimi i gjithë dhënave qe jane te publikuara ne Buletinit Zyrtar te APP-se rezulton se:

?

Operatori ekonomik MUHOPLUS Ltd shpk Tirane nuk ka realizuar asnjë furnizim të ngjashëm me makineri shtypshkrimi gjatë 3 viteve të fundit;

?

Objekti i veprimtarisë së tij lidhet me punime ndërtimore në sektorin e hidrocentraleve, pompave të ujit dhe veprave ujore, kabina elektrike;

Konkretisht sipas viteve per periudhen e viteve 2023 2024 2025, bazuar ne te dhenat e Buletineve te APP-se, rezulton se MUHOPLUS Ltd shpk Tirane ka fituar kontratat me subjektet shteterore si me poshte :

NE VITIN 2023 eshte shpallur fitues :

Korrik 2023 Fitues Buletini 64 date 24.07.2023

1. SH.A ALBPETROL REF- 73527-06-23-2023 Blerje lëkundës për QPN Fier dhe QPN Kuçovë , me fond limit 29,600,000 leke

Gusht 2023 Fitues Buletini 69 date 14.08.2023 drejtoria e shërbimit të trupit diplomatik REF- 74695-07-10-2023 Zëvendësim kaldaja; kryerje punimeve në sistemin e ngrohjes në pallatin nr.6 dhe nr.8 , me fond limit 19, 200, 376 leke

Shtator 2023 Fitues Buletini 80 date 25.09.2023 HEC LANABREGAS SH.A REF- 77437-08-15-2023 Rikonstrukion i Seksionit 6kV në HEC Lanabregas sh.a. (Faza e Dytë) . Fondi limit: 35,866,371 leke

Dhjetor 2023 Fitues Buletini 101 date 18.12.2023 BASHKIA SHIJAK REF- 88171-11-17-2023 F.V Pompë uji për stacionin e pompës Eminas i Vogël . Fondi limit: 2.160.000 leke

Pra sikurse evidentohet ne keto te dhena te sakta te Buletinit te APP-se, rezulton e vertetuar plotesisht se OE MUHOPLUS Ltd shpk, gjate vitit 2023 nuk ka realizuar asnje kontrate te ngjashme me makinerite e shtypi.

Paisjet per puset e naftes, kaldajat e pallateve, paisjet e HEC Lanabregas dhe pompat e ujit ne Shijak, nuk jane aspak te ngjashme me Makineritë e kerkuara ne tender, përkatësisht makineria e palosjes, makineria e prerjes dhe ajo e vijëzimit/perforimit.

Konkluzioni eshte se gjate vitit 2023, me entet shteterore nuk ka realizuar asnje kontrate te ngjashme me makinerite e shtypit te kerkuara ne tender.

NE VITIN 2024 eshte shpallur fitues :

Shkurt 2024 Fitues Buletini 9 date 19.02.2024 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E OBJEKTEVE PUBLIKE TIRANË REF- 92239-12-27-2023 Blerje materiale elektrike , me fond limit 39 999 991 leke

Maj 2024 Fitues Fitues Buletini 23 date 07.05.2024 SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SH.A REF- 98647-03-18-2024 Blerje materiale e pajisje elektrike, vegla, pajisje mekanike me fond limit 99.954.000 leke

Shtator 2024 Fitues Buletini 60 date 16.09.2024 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E OBJEKTEVE PUBLIKE TIRANË REF- 16121-08-13-2024 Blerje uniforma dhe veshje speciale , me fond limit 15 997 135 leke

Nentor 2024 Fitues Buletini 78 date 11.11.2024 SH.A Korporata elektroenergjitike shqiptare tiranë REF- 20981-09-20-2024 Rehabilitimi i galerisë së pjerrët në HEC Koman, FV dekovili i ri dhe rikonstrukion i sheshit mes galerisë së pjerrët dhe shpatit të djathtë në digën e Komanit me fond limit 90,435,579 leke

Edhe per vitin 2024, sikurse evidentohet me keto te dhena te sakta te Buletinit te APP-se, rezulton e vertetuar plotesisht se OE MUHOPLUS Ltd shpk, nuk ka realizuar asnje kontrate te ngjashme me makinerite e shtypi.

Materialet elektrike, materialet e ujesjellesit Durres, uniformat e veshjet, apo punimet per rikonstrukionin e HEC-it Koman, nuk jane aspak te ngjashme me Makineritë e kerkuara ne tender, përkatësisht makineria e palosjes, makineria e prerjes dhe ajo e vijëzimit/perforimit.

Konkluzioni eshte se gjate vitit 2024, me entet shteterore nuk ka realizuar asnje kontrate te ngjashme me makinerite e shtypit te kerkuara ne tender.

NE VITIN 2025 është shpallur fitues :

Shkurt 2025 Fitues Buletini 6 date 02.02.2025 Posta Shqiptare REF-33137-12-12-2024 Blerje Pajisje pune për shërbimet (Vula, dare vulosje, kuti postare) , me fond limit 10,509,133 leke

Mars 2025 Fitues Buletini 11 date 03.03.2025 AlbPetrol sh.a Pune REF-34831-12-30-2024 Ndërtim-montim i disa RVM-ve në Qëndrat e Albpetrol sh.a. me fond limit 59,897,190 leke

Prill 2025 Fitues Buletini 20 date 22.04.2025 SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME LUSHNJE SH.A Pune REF- 40401-03-06-2025 Shpim pusi në Libofshë per nevojat e shoqërisë me fond limit 3 550 000 leke

Gusht 2025 Fitues Buletini 42 date 11.08.2025 DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË OSSH SH.A REF- 51837-06-19-2025 Pajisje primare, sekondare dhe pajisje ndihmëse për N.Stacione dhe Linjat TL , me fond limit 199,831,677 leke

Edhe per vitin 2025, sikurse evidentohet me keto te dhena te sakta te Buletinit te APP-se, rezulton e vertetuar plotesisht se OE MUHOPLUS Ltd shpk, nuk ka realizuar asnje kontrate te ngjashme me makinerite e shtypi.

Vulat dhe kutite postare, rikonstruksioni objekteve Albpetrol, shpimi i puseve Libofshë, apo paisjet për N.Stacione dhe Linjat TL, nuk jane aspak te ngjashme me Makineritë e kerkuara ne tender, përkatësisht makineria e palosjes, makineria e prerjes dhe ajo e vijëzimit/perforimit.

Eshte mese e qarte se edhe gjate vitit 2025, MUHOPLUS Ltd shpk me entet shteterore nuk ka realizuar asnje kontrate te ngjashme me makinerite e shtypit te kerkuara ne tender.

Referuar te dhenave te sakta zyrtare te publikuara nga APP-ja, konkluzioni eshte se MUHOPLUS Ltd shpk gjate tre viteve te fundit 2023 2024 2025, nuk ka realizuar me ente shteterore asnje kontrate te ngjashme per makineri shtypi, objekt prokurimi.

Gjithashtu ne kontaktuar me pothuaj te gjitha subjektet private shtypshkronja qe operojne ne Shqiperi, me te cilat ne kryejme shitje te makinerive te shtypit, pjese kembimit per makinerite, furnizim me lende te pare per shtypin, servisim te makinerive te shtypit, te cilat na konfirmuan se ne asnje rast nuk kane marre asnje lloj furnizimi nga subjekti MUHOPLUS Ltd shpk Tirane.

Megjithate ne po supozojme se ndoshta subjekti MUHOPLUS Ltd shpk, mund te kete paraqitur ne tender fatura shitje per subjekte private te ndonje makinerie per shtypin????

Por menjehere lind pyetja se cila eshte ajo Shtypshkronje Private qe mund te bleje makineri te shtypit nga nje subjekt qe nuk ka asnje lidhje me furnizimin material te industrise se shtypit.

Makinerite e shtypit realisht kane nje kosto te shtrenjte, dhe askush nuk ka para te teperta qe ti besojne nje subjekti qe nuk ka eksperiencen e duhur te kesaj fushe specifike dhe te vecante, qe nuk disponon pjese kembimi ne rast avarie dhe nuk eshte marre asnjehere me servisimin e makinerive. Ne mendojme se nese OE MUHOPLUS Ltd, ka paraqitur fatura shitje per makineri shtypi te periudhes 202320242025, keto fatura shitje ose jane fiktive ose jane te fallsifikuara. Ne kete rast eshte detyrim ligjor i K.Sh.Ankesave, per te bere verifikim te ketij dokumentacioni.

Eshte mese e qarte se MUHOPLUS Ltd shpk Tirane, nuk permbush kapacitetin teknik dhe profesional, sepse rezulton qe kriteri i përvojës së ngjashme nga operatori ekonomik MUHOPLUS Ltd shpk nuk është përmbushur, dhe vendimi per kualifikim nuk qendron.

Persa me siper referuam bazuar ne klauzolat e nenit 77, te LPP, ku percaktohet se kualifikimi i një operatori pa përvojë të provuar përbën shkelje të këtij neni.

Ne perfundim te shkeljeve te argumentuar me siper kerkojme : - Fillimisht nga Autoriteti Kontraktor qe nepermjet Komisionit te Shqyrtimit te Ankesave te verifikoje me serizitet dokumentacionin qe operatori ekonomik MUHOPLUS Ltd shpk ka paraqitur per te argumentuar kontrata e ngjashme. - Ne besojme se Komisioni i Prokurimit Publik ka kapacitetin dhe mundesite reale per te bere verifikimet e duhura dhe kerkojme qe bazuar ne klauzolat e nenit 77, te urdherojë autoritetin kontraktor per skualifikimin e operatorit ekonomik MUHOPLUS Ltd shpk, sepse nuk permbush kriterin kualifikues te pikes 2.3.1 per kontrata te ngjashme.

II. Se dyti O.E MUHOPLUS Ltd shpk nuk ka Kapacitetin Teknik dhe Profesional per te realizuar kete kontrate sepse nuk permbush kriterin kualifikues te pikes 2.3.2 Kapaciteti teknik te Shtojces 8 FORMULARI I KRITEREVE TE PERZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT te DST-ve te modifikuara.

KONKRETISHT:

A)

O.E MUHOPLUS Ltd sipas kriterit kualifikues te siperpermendur ka dorezuar katalog dhe skede teknike per produktin e ofertuar Makineri shtypi për palosje gjysmë automatike , por nuk verteton permbushje e specifikimeve teknike te kerkuara per kete makineri ne Shtojcen 6 FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE te DST-ve, si me poshte:

?

Nuk verteton se ploteson specifikimin teknik Minimum katër pllaka palosëse me bllokim (buckle plates) dhe tre thika të komanduara, të cilat mundësojnë mekanikisht palosje paralele dhe të kryqëzuara, me mundësi shtesë për palosje të brendshme ose të jashtme në format 32 (formate të standardizuara të palosjes), si dhe palosje të dyfishta të brendshme në format 32 (ose 24 formate të standardizuara) , nuk ka katër pllaka palosëse me bllokim (buckle plates) dhe tre thika të komanduara, të cilat mundësojnë mekanikisht palosje paralele dhe të kryqëzuara, me mundësi shtesë për palosje të brendshme ose të jashtme në format 32 (formate të standardizuara të palosjes), si dhe palosje të dyfishta të brendshme në format 32 (ose 24 formate të standardizuara)

?

Nuk ploteson specifikimin teknik Funksion afishimi të gabimeve për diagnostikim dhe zgjidhje defektesh pasi nuk e ka kete funksion.

?

Nuk ploteson specifikimin teknik Sistem i avancuar për detektimin automatik të fletëve dyshe dhe të bllokuara pasi nuk e ka kete sistem te avancuar.

B)

O.E MUHOPLUS Ltd sipas kriterit kualifikues te siperpermendur ka dorezuar katalog dhe skede teknike per produktin e ofertuar Makineri e prerjes , por nuk verteton permbushje e specifikimeve teknike te kerkuara per kete makineri ne Shtojcen 6 FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE te DST-ve, si me poshte:

?

Nuk verteton se ploteson specifikimet Teknik Pajisje sigurie infra të kuqe me sensorë fotoelektrikë dhe butona sigurie për përdorim me të dyja duart. Pajisje sigurie për shtratin e thikës, mbrojtje nga mbingarkesa gjatë prerjes dhe pajisje automatike sigurie për rikthim pasi nuk e ka kete funksion.

?

Nuk ploteson specifikimin teknik Sistem PLC për monitorimin e gjithë zbatimit mekanik , pasi nuk e ka kete sistem te avancuar.

?

Nuk ploteson specifikimin teknik Pajisje mbrojtëse IR për prerje më të sigurt, sistem optik për rreshtimin e thikës, butona për operim me dy duar dhe cikël të vetëm prerjeje. Funksion vetë-diagnostikimi i gabimeve dhe shfaqje e mënyrës së funksionimit pasi nuk i ka keto pajisje e sisteme te avancuar.

C)

O.E MUHOPLUS Ltd sipas kriterit kualifikues te siperpermendur ka dorezuar katalog dhe skede teknike per produktin e ofertuar Makineri e vijëzimit/perforimit , por nuk verteton permbushje e specifikimeve teknike per kete makiberi te kerkuara ne Shtojcen 6 FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE te DST-ve, si me poshte:

?

Nuk verteton se ploteson specifikimin teknik Shpejtësia e punës: 24 copë/min (A4, prerje në 4 anë + 1 linjë palosjeje); 220 kartela/min (24 copë për herë), Detektimi i fletëve të dyfishta:

sensor ultrasonik me sistem hedhjeje të fletës së tepërt, Gjerësia e linjës së palosjes (Crease): standard 1.0 mm (2 copë), Rregullimi i thellësisë së palosjes: automatik sipas trashësisë së letrës, Palosje dhe perforim në një kalim: deri në 32 linja, 2 herë secila (64 linja gjithsej), Pritje (Slitting): 6 thika me rregullim automatik (standard), Prerje: deri në 32 herë në një kalim me Saktësi: ±0.2 mm, Kompensim për tkurrje ose shtrirje të figurës: në boshtin X dhe Y, Perforim i pjesshëm standard: rruga transversale 32 x 8 seksione; rruga lineare 2 linja x 16 seksione, Rregullimi i pjerrësisë (Skeë): automatik përmes softuerit , pasi makineria e ofruar nuk i permbush te gjithë parametrat e kerkuara, nderkohe qe referuar katalogut dhe skedes teknike nuk vertetohet se makineria e ofruar te plotesoje specifikimet teknike si ne vijim: Detektimi i fletëve të dyfishta: sensor ultrasonik me sistem hedhjeje të fletës së tepërt, Gjerësia e linjës së palosjes (Crease): standard 1.0 mm (2 copë);

Rregullimi i thellësisë së palosjes: automatik sipas trashësisë së letrës, Palosje dhe perforim në një kalim: deri në 32 linja, 2 herë secila (64 linja gjithsej).

III. Se treti *O.E MUHOPLUS Ltd shpk nuk ka Kapacitetin Teknik dhe Profesional per te realizuar kete kontrate sepse nuk permbush kriterin kualifikues te pikes 2.3.3 Kapaciteti teknik te Shtojces 8 FORMULARI I KRITEREVE TE PERZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT te DST-ve te modifikuar.*

A)

Sikurse parashtruam me siper per plotesimin e kriterit 2.3.3 Kapaciteti teknik te Shtojces 8 te DST-ve O.E MUHOPLUS ka dorezuar skeda teknike dhe kataloge per produktet e ofruara, por nuk ka

dorezuar dokumentin DEKLARATË FURNIZIMI NGA PRODHUESI te leshuar nga prodhuesi i deklaruar ne skeden teknike dhe katalogun e dorezuar per produktin e ofruar Makineri shtypi për palosje gjysmë automatike .

O.E MUHOPLUS ka dorezuar skeda teknike dhe kataloge per produktet e ofruara, por nuk ka dorezuar dokumentin DEKLARATË FURNIZIMI NGA DISTRIBUTORI i AUTORIZUAR te leshuar nga distributori i autorizuar nga prodhuesi i deklaruar ne skeden teknike dhe katalogun e dorezuar per produktin e ofruar Makineri shtypi për palosje gjysmë automatike , si dhe nuk ka paraqitur dokumentin Akt Marrëveshje midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme midis tyre, sikurse kerkohet ne DST

B)

Sikurse parashtruam me siper per plotesimin e kriterit 2.3.3 Kapaciteti teknik te Shtojces 8 te DST-ve O.E MUHOPLUS ka dorezuar skeda teknike dhe kataloge per produktet e ofruara, por nuk ka dorezuar dokumentin DEKLARATË FURNIZIMI NGA PRODHUESI te leshuar nga prodhuesi i deklaruar ne skeden teknike dhe katalogun e dorezuar per produktin e ofruar Makineri Prerje.

O.E MUHOPLUS ka dorezuar skeda teknike dhe kataloge per produktet e ofruara, por nuk ka dorezuar dokumentin DEKLARATË FURNIZIMI NGA DISTRIBUTORI i AUTORIZUAR te leshuar nga distributori i autorizuar nga prodhuesi i deklaruar ne skeden teknike dhe katalogun e dorezuar per produktin e ofruar Makineri Prerje , si dhe nuk ka paraqitur dokumentin Akt Marrëveshje midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme midis tyre , sikurse kerkohet ne DST C)

Sikurse parashtruam me siper per plotesimin e kriterit 2.3.3 Kapaciteti teknik te Shtojces 8 te DST-ve O.E MUHOPLUS ka dorezuar skeda teknike dhe kataloge per produktet e ofruara, por nuk ka dorezuar dokumentin DEKLARATË FURNIZIMI NGA PRODHUESI te leshuar nga prodhuesi i deklaruar ne skeden teknike dhe katalogun e dorezuar per produktin e ofruar Makineri e vijëzimit/perforimit .

O.E MUHOPLUS ka dorezuar skeda teknike dhe kataloge per produktet e ofruara, por nuk ka dorezuar dokumentin DEKLARATË FURNIZIMI NGA DISTRIBUTORI i AUTORIZUAR te leshuar nga distributori i autorizuar nga prodhuesi i deklaruar ne skeden teknike dhe katalogun e dorezuar per produktin e ofruar Makineri e vijëzimit/perforimit , si dhe nuk ka paraqitur dokumentin Akt Marrëveshje midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme midis tyre , sikurse kerkohet ne DST.

IV. Se Katerti O.E MUHOPLUS Ltd shpk nuk ka Kapacitetin Profesional per te realizuar kete kontrate sepse nuk permbush kriterin kualifikues te pikes 2.3.5 te Shtojces 8 FORMULARI I KRITEREVE TE PERZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT te DST-ve te modifikuara, ne lidhje me automjetin e transportit me peshëmbajtje jo më pak se 5 (pesë) ton.

Ne kriteret e vecanta te kualifikimit te DST eshte kerkuar që :

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në pronësi ose qira, të paktën 1 (një) automjet me peshëmbajtje jo më pak se 5 (pesë) ton. Për vërtetimin e kësaj kërkese duhet të paraqesë dokumentacionin shoqërues për qarkullimin e automjetit (Lejen e Qarkullimit, Siguracionin, Kolaudimin, Taksën e Qarkullimit) të vlefshme, ose në rast se nuk e ka automjetin në pronësi të

paraqesë kontratën e qirasë si dhe dokumentacionin shoqërues për qarkullimin e automjetit (Lejen e Qarkullimit, Siguracionin, Taksën e Qarkullimit, Kolaudimin,) të vlefshme.

O.E MUHOPLUS Ltd sipas kriterit kualifikues të sipërpermendur ka dorëzuar dokumentacionin e makines së transportit, por nuk vertetohet se automjeti që disponon është i pajisur vecanerisht me Certifikatën për Transport Mallrash për të Tretet dhe me Qera brenda vendit, sipas parashikimeve të nenit 81, pika 1, 2, 3, 4, 5 dhe 7, 8 Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve të ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar. Ne gjykojmë se duke qene subjekt me aktivitet ndertimor kerkojme qe te verifikohen dokumentacioni i dorëzuar nga Operatori ekonomik MUHOPLUS Ltd shpk Tirane ne lidhje me kerkesen per automjetin me peshëmbajtje jo më pak se 5 (pesë) ton.

V. Se pesti *O.E MUHOPLUS Ltd shpk nuk ka arritur të argumentojë ofertën e tij ekonomike e cila ka rezultuar anomalisht e ulët.*

Operatori ekonomik MUHOPLUS Ltd shpk Tirane, paraqiti ofertën ekonomike me vlerën prej 13.800.000 leke pa TVSH, e cila rezulton se është anomalisht e ulët. [...]

Autoritetet ose entet kontraktore e refuzojnë ofertën kur konstatojnë se oferta është anomalisht e ulët, sepse nuk pajtohet me detyrimet e zbatueshme nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës e të akteve të tjera??

Theksojmë se bëhet fjalë për makineri të reja të gjenerates së fundit, të cilat kanë një kosto monetare shumë të lartë. Vetë autoriteti kontraktor në shtojcën e publikuar ka evidentuar se : Makineritë e përfshira në kontratë, përkatësisht makineria e palosjes, makineria e prerjes dhe ajo e vijëzimit/perforimit, përbëjnë pajisje industriale me kompleksitet të lartë teknik, të cilat përfshijnë sisteme të kombinuara mekanike dhe elektrike. Ato janë të pajisura me motorë të fuqishëm, sisteme të automatizuara kontrolli (PLC), sensorë infra të kuq dhe ultrasonikë, ekrane me prekje, mekanizma sigurie dhe sisteme diagnostikimi, që kërkojnë instalim dhe konfigurim profesional në përputhje me manualët e prodhuesit.

Sqarojmë se sistemet e kombinuara të këtyre makinerive janë të vështira për tu prodhuar, dhe një subjekt pa përvojë në këtë fushë sikurse MUHOPLUS Ltd, nuk mund të realizojë këto makineri me cilësinë dhe specifikimet e kërkuara, që janë me kompleksitet të lartë teknik.

KVO e ka pranuar ofertën anomalisht të ulët, por oferta është e paargumentuar sepse:

?

Nuk është argumentuar sikurse kërkohet në Nenin 93 të LPP ana ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit, për faktin se MUHOPLUS Ltd shpk nuk ka realizuar me pare kontrata për makineri shtypi. Prodhuuesi nuk është në dijeni të cmimit të ofruar nga distributori, prandaj ana ekonomike të procesit të prodhimit, nuk është e sakte.

Nuk janë përlogaritur saktë shpenzimet e tjera mbi kosto sikurse janë shpenzimet e transportit, shpenzimet për sigurimin e ngarkesës, shpenzimet doganore, shpenzimet e përgjithshme, të ngarkim shkarkimit etj. Nuk janë përlogaritur saktë shpenzimet për venien në punë të makinerisë,

shpenzimet per pagesat e specialisteve te huaj, shpenzimet per trainimin e personelit etj.

?

Nuk eshte argumentuar sikurse kerkohet ne Nenin 93, zgjidhja teknike e perzgjedhur pasi mungon lidhja organike midis prodhuesit dhe distributorit. Nuk ka llogaritje te sakta te kosos se prodhimit pasi oferten e ka marre nga distributori, i cili nuk eshte kopetent per te percaktuar cmimin.

?

Nuk ka ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm të ofertuesit sepse se MUHOPLUS Ltd shpk nuk ka realizuar me pare kontrata per makineri shtypi.

?

Nuk ka asnje te dhene ne lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi, pasi MUHOPLUS Ltd shpk nuk ka asnje experience ne kete fushe.

?

Nuk ka asnje te dhene ne lidhje me pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës. [...]"

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 654/1 Prot., datë 03.03.2026.

II.6. Në datën 11.03.2026 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 654/2 prot., shkresa e operatorit ekonomik ankimues me nr. 238/4 prot., datë 09.03.2026 me objekt: “Kthim përgjigje ankesës së operatorit ekonomik” drejtuar operatorit ekonomik ankimues, për dijeni Komisionit të Prokurimit Publik.

Referuar kësaj shkrese, rezulton se pretendimet e ankimuesit janë refuzuar, duke argumentuar si vijon:

“[...]”

1) Përsa i përket ankesës së operatorit ekonomik 4E-COLOR SHPK, me pretendimin që operatori ekonomik fitues nuk ka kryer fumizime të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se 40% e vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ju sqarojmë si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik ankimues pretendon se operatori ekonomik i shpallur fitues nuk plotëson kërkesën e percaktuar në pikën 2.3.1 të Kapacitetit Teknik, sipas Shtojcës 8 të Dokumenteve Standarde të Tenderit, me argumentin se ky operator nuk ka paraqitur fumizime të njëjta me objektin e kontratës dhe, për pasojë, nuk mund të realizojë kontratën. Autoriteti kontraktor e konsideron këtë pretendim të pabazuar si në aspektin ligjor ashtu edhe në atë teknik.

Së pari, nga pikëpamja ligjore, kriteri i përcaktuar në dokumentet e tenderit kërkon paraqitjen e furnizimeve të ngjashme, dhe jo furnizime identike me objektin e prokurimit. Legjislacioni në fuqi për prokurimin publik, si dhe praktika e konsoliduar e autoriteteve kontraktore dhe e Komisionit të Prokurimit Publik, nuk kërkon në asnjë rast që operatori ekonomik të ketë realizuar kontrata identike me objektin e prokurimit, por vetëm kontrata që dëshmojnë përvojë të krahasueshme në natyrë, kompleksitet dhe funksionalitet.

Kjo qasje është në përputhje edhe me logjikën e përgjithshme të së drejtës së prokurimit publik, e cila synon të verifikojë kapacitetin real profesional dhe teknik të operatorit ekonomik, dhe jo të kufizojë konkurrencën duke kërkuar përvoja identike që në praktikë do të reduktonin padrejtësisht numrin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në treg. Për më tepër, interpretimi i bërë nga operatori ekonomik ankimues, sipas të cilit kërkohen furnizime të njëjta, përbën një interpretim të zgjeruar dhe të pabazuar të kriterit të vendosur në dokumentet e tenderit, duke tentuar të barazojë dy koncepte juridikisht dhe teknikisht të ndryshme, përkatësisht “furnizime të ngjashme” dhe “furnizime identike”.

Së dyti, edhe nga pikëpamja teknike, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Makinëritë objekt i kësaj procedure prokurimi, sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit, nuk përbëjnë makineri të mirëfillta shtypshkrimi, por pajisje që mbështesin dhe asistojnë procesin e zinxhirit të prodhimit, duke qenë pjesë e sistemit teknik që mundëson funksionimin dhe automatizimin e proceseve industriale. Në praktikën industriale dhe teknologjike, pajisje të tilla konsiderohen pajisje ndihmëse ose komponentë funksionalë të sistemeve teknologjike, të cilat përdoren në procese të ndryshme prodhimi dhe nuk janë të kufizuara vetëm në industrinë e shtypshkrimit. Në këtë kuptim, përvoja e operatorit ekonomik në furnizimin e pajisjeve teknike të ngjashme, të cilat kryejnë funksione të krahasueshme teknologjike dhe operacionale, përbën një tregues të mjaftueshëm për të vërtetuar kapacitetin e tij teknik për realizimin e kontratës.

Në këtë drejtim, operatori ekonomik i shpallur fitues ka paraqitur dokumentacion që provon realizimin e një sërë furnizimesh të ngjashme me natyrë teknike të krahasueshme, ndër të cilat përfshihen furnizime me pajisje elektromekanike, pompa industriale, panele elektrike dhe komponentë të sistemeve teknologjike. Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton, ndër të tjera, furnizimi me pajisje teknike dhe elektromekanike si elektropompa industriale, inverterë dhe panele elektrike të kontrollit, të cilat janë komponentë tipikë të sistemeve të automatizimit dhe kontrollit industrial.

Po kështu, në furnizimet e realizuara përfshihen edhe sisteme dhe komponentë teknike si panel elektrik me soft-starter, motorë elektrikë dhe pajisje të tjera elektroteknike, të cilat përbëjnë elementë thelbësorë të sistemeve teknologjike industriale. Gjithashtu, dokumentacioni i paraqitur provon realizimin e furnizimeve me pompa centrifugale, pompa zhytëse dhe panele kontrolli industriale, të cilat janë pajisje me karakteristika të ngjashme funksionale dhe teknike me pajisjet që përdoren në procese të ndryshme industriale. Në këtë kuadër, përvoja e dokumentuar e

operatorit ekonomik fitues dëshmon qartë se ai ka realizuar furnizime që per nga natyra teknologjike, kompleksiteti teknik dhe funksionaliteti industrial janë të krahasueshme me objektin e kontrates.

Së treti, edhe nga këndvështrimi i së drejtës tregtare dhe civile, kontratat e furnizimit nuk klasifikohen sipas identitetit absolut të mallrave të furnizuara, por sipas natyrës ekonomike dhe teknike të veprimtarisë së ushtruar nga operatori ekonomik. Në praktikën e marrëdhënieve tregtare, një operator ekonomik që furnizon pajisje dhe sisteme teknike të një fushe të caktuar industriale konsiderohet se zotëron kapacitetin profesional për furnizime të ngjashme brenda kategorive të përafërta teknologjike, edhe në rastet kur specifikimet konkrete të pajisjeve ndryshojnë.

Në përfundim, nga analiza e dokumentacionit të paraqitur dhe nga interpretimi i drejtë i kërkesës së përcaktuar në pikën 2.3.1 të Kapacitetit Teknik, rezulton se: dokumentet e tenderit kërkojnë furnizime të ngjashme, dhe jo furnizime identike; operatori ekonomik i shpallur fitues ka paraqitur dokumentacion që provon realizimin e furnizimeve të ngjashme; përvoja e paraqitur dëshmon kapacitetin teknik dhe profesional për realizimin e kontratës.

Për rrjedhojë, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues se operatori ekonomik fitues nuk plotëson kriterin e kapacitetit teknik të pikës 2.3.1 sipas Shtojcës 8 të Dokumenteve Standarde të Tenderit, nuk qëndron dhe duhet rrëzuar si i pabazuar në fakte dhe bazën ligjore në fuqi.

2) Përsa i përket ankesës së operatorit ekonomik 4E-COLOR SHPK, me pretendimin që operatori ekonomik fitues nuk ka paraqitur saktë katalogët/fragmente të katalogut ose skedat teknike për mallrat objekt prokurimi, dhe makineritë e ofertuara nuk i plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit, ju sqarojmë si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik ankimues 4E-COLOR SHPK pretendon se operatori ekonomik i shpallur fitues nuk ka paraqitur saktë katalogët, fragmentet e katalogut ose skedat teknike për mallrat objekt prokurimi, si dhe se makineritë e ofertuara nuk përmbushin kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit, në kundërshtim me pikën 2.3.2 të Kapacitetit Teknik, sipas Shtojcës 8 të Dokumenteve Standarde të Tenderit. Autoriteti kontraktor e konsideron edhe këtë pretendim të pabazuar në fakt dhe në ligj.

Së pari, nga pikëpamja formale-juridike, kërkesa e pikës 2.3.2 nuk parashikon detyrimin për paraqitjen e një forme të vetme dokumentacioni teknik, por lejon shprehimisht paraqitjen e katalogëve, fragmenteve të katalogut ose skedave teknike, me kusht që ato të tregojnë qartë produktet e përzgjedhura, të identifikojnë katalogun ose prodhuesin përkatës dhe të përmbajnë karakteristikat teknike të nevojshme që i japin mundësi autoritetit kontraktor të vlerësojë përputhshmërinë me specifikimet e kërkuara në DST.

Nga dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik fitues rezulton se ky detyrim është përmbushur. Dokumentacioni teknik i dorëzuar përmban autorizimet e prodhuesve për secilën prej makinerive të ofertuara, ku identifikohet qartë prodhuesi dhe procedura konkrete e prokurimit; në

faqet 2, 5 dhe 10 të dosjes teknike gjenden autorizimet përkatëse të prodhuesve për makinerinë e palosjes, makinerinë e vijëzimit/perforimit dhe makinerinë e prerjes. Po ashtu, skedat teknike dhe materialet përshkruese identifikojnë modelet konkrete të makinerive dhe parametrat e tyre teknikë; për makinerinë e palosjes këto paraqiten në faqet 3, 15 dhe 16, për makinerinë e prerjes në faqet 11, 12, 23, 24 dhe 25, ndërsa për makinerinë e vijëzimit/perforimit në faqet 6, 7, 18, 19, 20 dhe 21 të dokumentacionit teknik. Pra, dokumentacioni teknik i paraqitur nuk është as i paidentifikueshëm dhe as i paplotë. Përkundrazi, ai i jep autoritetit kontraktor mundësinë reale dhe të mjaftueshme për të bërë verifikimin teknik të mallrave të ofruara.

Së dyti, nga pikëpamja teknike, pretendimi i ankimuesit nuk qëndron, pasi parametrat e makinerive të ofertuara rezultojnë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në Shtojcën 6 — Formulari i Specifikimeve Teknike.

Autoriteti kontraktor ka kërkuar për makinerinë për palosje gjysmë automatike, ndër të tjera: përmasa maksimale flete 780 x 1160 mm, përmasa minimale flete 150 x 200 mm, gjerësi minimale për palosje paralele 55 mm, shpejtësi maksimale palosjeje 230 m/min, frekuencë maksimale e thikës së palosjes 350 goditje/min, trashësi letre 40-120 g/m², fuqi makinerie 7.8 kË, përmasa minimale 5400 x 2120 x 1630 mm, dhe peshë neto minimum 2400 kg.

Makineria e ofruar nga operatori fitues, model ZYHD780D, sipas dokumentacionit teknik, paraqet pikërisht këto karakteristika: max. sheet size 780 K 1160 mm, min. sheet size 150 x 200 mm, min. ëdth of parallel folding 55 mm, max. folding speed 230 m/min, max. folding knife cycle rate 350 strokes/min, sheet thickness 40—120 g/ 2\$ poëer 7.8 kË, overall dimensions 5400 x 2120 x 1630 mm, machine net ëeight 2400 kg.

Edhe në aspektin funksional, dokumentacioni teknik evidenton se kjo makineri është e pajisur me katër pllaka palosëse, tre thika të komanduara, feeder ndarës fletësh, sistem detektimi të fletëve dyshe, ekran kontrolli dhe funksione të diagnostikimit të gabimeve, siç pasqyrohet në përshkrimin teknik dhe listën e pjesëve. Kjo do të thotë se jo vetëm parametrat numerikë, por edhe arkitektura funksionale e makinerisë përputhet me kërkesat e autoritetit kontraktor.

Për makinerinë për prerje letre, Shtojca 6 kërkon: gjerësi prerjeje 115 cm, lartësi maksimale prerjeje 16.5 cm, thellësi maksimale prerjeje 115 cm, thellësi minimale 2.5 cm, gjatësi të zgjeruar të tavolinës 73 cm, lartësi tavoline 88-92 cm, gjerësi makinerie 266 cm, gjerësi totale tavoline 226 cm, shpejtësi prerjeje 45 r/min, presion maksimal 40,000 N, motor kryesor 4 kË, motor ushqyes 0.75 kË, pompë ajri 0.75 kË, peshë 4000 kg, dhe përmasa 255 x 160 x 215 cm.

Makineria e ofruar nga operatori fitues, modeli 115F+ Program Control Paper Cutter, sipas tabelës teknike të paraqitur në dokumentacionin teknik, paraqet pikërisht këto karakteristika: cutting ëdth 115 cm, max cutting height l 6.5 cm, max cutting depth 115 cm, min cutting depth 2.5 cm, extended length of ëorking table 73 cm, height of ëorking table 88—92 cm, machine ëdth including side ëorking table 266 cm, total length of ëorking table 226 cm, cutting speed 45 r/min,

max paper pressure 40000 N, poëer of main motor 4 kË, motor for paper feeding 0.75 kË, air pump 0.75 kË, machine  eight 4000 kg, dhe overall dimensions 255 x 1 60 x 215 cm.

Po ashtu, nga dokumentacioni teknik rezultojn  edhe funksionalitetet shtes  t  k rkuara si ekran me prekje, programim dhe kontroll PLC, sistem optik p r prerjen, operim me dy duar, pajisje sigurie dhe vet diagnostikim p r sistemin e prerjes. Pra, p r k t  makineri kemi nj  korrespondenc  t  drejtp rdrejt  dhe t  plot  parametrash mes k rkes s dhe ofert s teknike.

P r makinerin  p r vij zim dhe perforim, autoriteti kontraktor ka k rkuar nd r t  tjera parametra si: infeed 210 x 210 mm — 370 x 900 mm, outfeed 50 x 48 mm — 370 x 1200 mm, pesh  letre 150—400 gsm, kapacitet ngarkimi 150 mm, shpejt si pune 24 cop /min dhe 220 kartela/min, sensor ultrasonik p r flet  dyshe, gjer si linje palosjeje 1.0 mm, rregullim automatik t  thell sis , deri n  32 linja p r palosje/perforim, 6 thika slitting, sakt si +0.2 mm, ekran me prekje 9 in , rregullim automatik t  pjerr sis  dhe modul palosje/perforimi 2. Dokumentacioni teknik i makineris  model 9375BSC s  ofruar nga prodhuesi Huizhou Ausjetech Co., Ltd. paraqet nj  makineri Slit/Cut/Crease me funksione slit, cut dhe crease/perforate, ekran me prekje, korrigjim regjistrimi n  boshtet X dhe Y, sensor p r flet  dyshe, module p r palosje/perforim, thika slitting dhe rregullime automatike, duke identifikuar qart  produktin, prodhuesin dhe funksionet kryesore t  k rkuara. Edhe pse dokumentacioni i k saj pajisjeje paraqitet n  form  m  vizuale dhe funksionale, ai identifikon qart  produktin dhe funksionet e tij dhe i jep autoritetit kontraktor baz  t  mjaftueshme p r t  verifikuar p rputhshm rin  me k rkesat e DST.

S  treti, duhet theksuar se vler simi sipas pik s 2.3.2 nuk k rkon q  katalogu t  riprodhoj  fjal  p r fjal  tekstin e dokumenteve t  tenderit, por q  dokumentacioni teknik t  p rmbaj  t  dh na t  mjaftueshme q  lejojn  identifikimin e produktit dhe verifikimin e p rputhshm ris  teknike. Pik risht kjo ka ndodhur n  rastin konkret. Nga kjo pik pamje, pretendimi i ankimuesit  sht  i gabuar edhe metodologjikisht, sepse ai tenton t  z vend soj  standardin e k rkuar nga dokumentet e tenderit me nj  standard m  t  ngurt , i cili nuk  sht  parashikuar as n  pik n 2.3.2 dhe as n  legjislacionin p r prokurimin publik.

S  kat rti, edhe n  planin funksional, makinerit  e ofruara nga operatori ekonomik fitues p rmbushin k rkesat e autoritetit kontraktor, pasi makineria e palosjes realizon procesin e palosjes s  kontrolluar me thik  elektrike dhe feeder automatik; makineria e prerjes realizon prerje precize me kontroll programi, siguri operative dhe sistem hidraulik presioni; nd rsa makineria e vij zimit/perforimit realizon slit, cut, crease dhe perforate n  nj  sistem t  integruar p r p rpunimin e letr s dhe kartelave. Kjo tregon se p rputhja nuk  sht  vet m numerike, por edhe teleologjike dhe funksionale, pra makinerit  e ofruara i sh rbejn  sakt sisht q llimit teknik t  parashikuar nga autoriteti kontraktor.

N  p rfundim, rezulton qart  se operatori ekonomik fitues ka paraqitur dokumentacion teknik t  vlefsh m sipas pik s 2.3.2, katalog t, fragmentet dhe skadat teknike identifikojn  qart  prodhuesit dhe produktet, parametrat teknik  t  makinerive t  ofruara jan  n  p rputhje me k rkesat e Shtojc s 6, dhe funksionaliteti i pajisjeve t  ofruara p rputhet me nevojat dhe q llimin e kontrat s.

Për rriedhojë, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues se operatori ekonomik fitues nuk ka paraqitur saktë katalogët ose se makineritë e ofruara nuk përmbushin specifikimet teknike duhet rrëzuar si i pabazuar në fakt, në dokumentacionin teknik të paraqitur dhe në interpretimin korrekt të dokumenteve të tenderit.

3) *Përsa i përket ankesës së operatorit ekonomik 4E-COLOR SHPK, me pretendimin që operatori ekonomik fitues nuk ka paraqitur deklaratë furnizimi nga prodhuesi/ distributori të autorizuar, për këtë procedurë prokurimi (objekt, nr.REF), ose autorizim prodhuesi/ distributori zyrtar për mallrat objekt të prokurimit, ju sqarojmë si më poshtë vijon:*

Në pikën e tretë të ankesës, operatori ekonomik ankimues 4E-COLOR SHPK pretendon se operatori ekonomik i shpallur fitues nuk ka paraqitur deklaratë furnizimi nga prodhuesi apo distributori i autorizuar për këtë procedurë prokurimi, ose autorizim nga prodhuesi/distributori zyrtar për mallrat objekt të prokurimit, në kundërshtim me kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.3 të Kapacitetit Teknik, sipas Shtojcës 8 të Dokumenteve Standarde të Tenderit. Autoriteti kontraktor e konsideron këtë pretendim të pabazuar si në aspektin faktik ashtu edhe në atë juridik, pasi nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik fitues rezulton qartë se ky kriter kualifikimi është përmbushur plotësisht.

Së pari, *nga pikëpamja formale-juridike, kërkesa e pikës 2.3.3 parashikon që operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë furnizimi nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për këtë procedurë prokurimi (objekt dhe numër reference), ose autorizim nga prodhuesi apo distributori zyrtar për mallrat objekt të prokurimit. Gjithashtu, kjo kërkesë parashikon që deklarata e furnizimit ose autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit, si numrin e telefonit, adresën elektronike, faqen zyrtare të internetit dhe çdo të dhënë tjetër identifikuese, në mënyrë që autoriteti kontraktor të ketë mundësi të kryejë verifikimin e tyre në rast nevojë. Nga dokumentacioni i dorëzuar në ofertë rezulton se operatori ekonomik fitues ka paraqitur autorizime të prodhuesve për të gjitha makineritë objekt prokurimi, të cilat janë përfshirë në dokumentacionin teknik të ofertës dhe janë përkthyer e noterizuar sipas legjislacionit shqiptar, duke përmbushur kështu kërkesat e dokumenteve të tenderit.*

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se për makinerinë e palosjes është paraqitur autorizimi i prodhuesit Changsha ATA Machinery Co LTD, i cili deklaron shprehimisht se prodhuesi autorizon operatorin ekonomik të paraqesë ofertë dhe të furnizojë mallrat në kuadër të kësaj procedure prokurimi me referencë REF-67300-10-30-2025, duke garantuar njëkohësisht cilësinë dhe mbështetjen për produktet e ofruara. Ky autorizim përmban të dhënat identifikuese të prodhuesit, përfshirë adresën e prodhuesit dhe deklarin e autorizimit për furnizimin e mallrave në këtë procedurë konkrete prokurimi.

Në të njëjtën mënyrë, për makinerinë e vijëzimit dhe perforimit është paraqitur autorizimi i prodhuesit Huizhou Ausjetech Co., Ltd., i cili autorizon operatorin ekonomik të marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe të furnizojë pajisjet përkatëse në rast shpalljeje fituesi, duke garantuar gjithashtu mbështetjen teknike dhe cilësinë e produkteve të ofruara. Edhe ky autorizim

përmban të dhënat identifikuese të prodhuesit dhe referencën e procedurës së prokurimit, duke përmbushur kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Po ashtu, për makinerinë për prerje letre është paraqitur autorizimi i prodhuesit Zhejiang Guoëei Intelligent Equipment Co.. Ltd., i cili deklaron autorizimin për pjesëmarrjen në procedurën e prokurimit dhe furnizimin e pajisjeve në rast shpalljeje fituesi, duke identifikuar qartë prodhuesin dhe procedurën konkrete të prokurimit për të cilën lëshohet autorizimi.

Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik fitues është përkthyer zyrtarisht dhe vërtetuar nga noteri, duke konfirmuar autenticitetin dhe vlefshmërinë e tij për përdorim në procedurat administrative dhe kontraktore në Republikën e Shqipërisë. Ky element garanton vlefshmërinë juridike të dokumenteve dhe përputhjen e tyre me kërkesat e legjislacionit shqiptar për dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaj.

Së dyti, nga pikëpamja teknike dhe funksionale, autorizimet e prodhuesve lidhen drejtpërdrejt me pajisjet konkrete të ofruara në ofertën teknike të operatorit ekonomik fitues dhe përputhen me dokumentacionin teknik të paraqitur për këto pajisje. Në këtë mënyrë krijohet një lidhje e qartë midis prodhuesit, produktit dhe operatorit ekonomik ofertues, çka është pikërisht qëllimi i kriterit të parashikuar në pikën 2.3.3 të dokumenteve të tenderit. Ky kriter synon të sigurojë që operatori ekonomik të ketë një marrëdhënie të vlefshme furnizimi me prodhuesin ose me një distributor të autorizuar dhe që furnizimi i pajisjeve të jetë i garantuar nga burimi zyrtar i prodhimit.

Së treti, në planin interpretues dhe juridik, kërkesa e pikës 2.3.3 nuk kërkon një formë të vetme standarde të autorizimit, por kërkon vetëm që dokumenti i paraqitur të identifikojë prodhuesin, të autorizojë operatorin ekonomik për furnizimin e mallrave dhe të përmbajë të dhënat identifikuese të prodhuesit për qëllime verifikimi nga autoriteti kontraktor. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik fitues i përmbush të gjitha këto elemente dhe, për rrjedhojë, përmbush plotësisht kërkesën e dokumenteve të tenderit.

Në përfundim, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në ofertë rezulton qartë se operatori ekonomik fitues ka paraqitur autorizime të vlefshme nga prodhuesit për makineritë objekt prokurimi, të cilat identifikojnë prodhuesit, autorizojnë pjesëmarrjen në këtë procedurë prokurimi dhe përmbajnë të dhënat e nevojshme për verifikim nga autoriteti kontraktor.

Për rrjedhojë, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues se operatori ekonomik fitues nuk ka paraqitur deklaratë furnizimi apo autorizim prodhuesi sipas kërkesave të pikës 2.3.3 të Kapacitetit Teknik është i pabazuar në fakt dhe në dokumentacionin e paraqitur në procedurë, dhe si i tillë duhet të rrëzohet.

4) *Përsa i përket ankesës së operatorit ekonomik 4E-COLOR SHPK, me pretendimin që operatori ekonomik fitues nuk ka paraqitur nuk ka paraqitur dokumentacion që të vërtetojë posedimin në pronësi ose me qira, për të paktën 1 (një) automjet me peshëmbajtje jo më pak se 5*

(pesë) ton, dhe se automjeti i ofruar nuk i plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit, ju sqarojmë si më poshtë vijon:

Në pikën e katërt të ankesës së tij, operatori ekonomik 4E-COLOR SHPK pretendon se operatori ekonomik fitues MUHOPLUS LTD SHPK nuk ka paraqitur dokumentacion që të vërtetojë posedimin në pronësi ose me qira të një automjeti me peshëmbajtje jo më pak se 5 (pesë) ton, si dhe pretendon se nuk është paraqitur dokumentacioni shoqërues për qarkullimin e automjetit dhe certifikata “Për transport mallrash për të tretët dhe me qira brenda vendit”, sipas kërkesës së përcaktuar në pikën 2.3.5 të Kapacitetit Teknik, në Shtojcën 8 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Autoriteti kontraktor e kundërshton këtë pretendim si të pabazuar në fakt dhe në dokumentacion, pasi nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura nga operatori ekonomik fitues rezulton qartë se ky kriter kualifikimi është përmbushur në mënyrë të plotë dhe në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit.

Së pari, sipas formulimit të vetë kriterit në dokumentet e tenderit, është përcaktuar shprehimisht se plotësimi i këtij kriteri në fazën e ofertimit konsiderohet i përmbushur përmes deklaramit në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (Shtojca 9), ndërsa dokumentacioni i plotë shoqërues për automjetin paraqitet në momentin kur operatori ekonomik renditet i pari në vlerësim, përpara publikimit të njoftimit të fituesit ose në rast kërkese për sqarime nga autoriteti kontraktor. Ky formulim është i qartë dhe nuk lë vend për interpretim {jetër.

Në përputhje me këtë kërkesë, operatori ekonomik MUHOPLUS LTD SHPK ka paraqitur në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në pjesën III “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, deklaramin për disponimin e mjeteve dhe makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës. Në këtë deklaram ai ka specifikuar qartë se disponon kamion me qira me kapacitet 6.7 ton, duke identifikuar gjithashtu targën e mjetit AB551 IU dhe të dhënat përkatëse të mjetit transportues. Ky deklaram përputhet plotësisht me kërkesën e dokumenteve të tenderit dhe përbën provë të mjaftueshme në fazën e ofertimit, sipas parashikimit të vetë kriterit të kualifikimit.

Së dyti, në përputhje me kërkesën e autoritetit kontraktor, operatori ekonomik fitues ka paraqitur edhe dokumentacionin e plotë shoqërues për automjetin e deklaruar. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se është paraqitur Leja e Qarkullimit e automjetit, nga e cila rezulton se mjeti është kamion i markës Mercedes Benz, modeli 16-22AK, me targë AB551 IU, i regjistruar për transport mallrash.

Gjithashtu është paraqitur polica e sigurimit të detyrueshëm të mjetit motorik, e vlefshme për periudhën përkatëse, e cila vërteton mbulimin e detyrueshëm të përgjegjësisë ndaj palëve të treta gjatë qarkullimit të automjetit në rrugë.

Në dokumentacionin e dorëzuar është përfshirë gjithashtu edhe dokumentacioni për taksën vjetore të mjetit, i cili vërteton pagesën e detyrimeve përkatëse për përdorimin e automjetit në qarkullim rrugor, si dhe certifikata e kontrollit teknik të mjetit, nga e cila rezulton se automjeti ka kaluar

kontrollin teknik dhe është i vlefshëm për qarkullim deri në datën 07.04.2026, duke përmbushur kështu kërkesën për kolaudim të vlefshëm.

Po kështu, në dokumentacionin e paraqitur gjendet edhe Certifikata “Për transport mallrash për të tretët dhe me qira brenda vendit”, e lëshuar nga autoriteti përkatës, e cila identifikon qartë automjetin me targë AB551 IU, markë Mercedes Benz, dhe autorizon përdorimin e tij për transport mallrash për të tretët brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Kjo certifikatë rezulton e vlefshme, duke përmbushur në mënyrë të plotë kërkesën e dokumenteve të tenderit për këtë lloj autorizimi.

Nga analiza e të gjithë këtij dokumentacioni rezulton qartë se automjeti i deklaruar nga operatori ekonomik fitues përmbush plotësisht kërkesën e përcaktuar në dokumentet e tenderit për disponimin e një automjeti transporti me kapacitet mbi 5 ton, pasi nga dokumentet e paraqitura rezulton se automjeti i deklaruar ka kapacitet transporti 6.7 ton, pra mbi kufirin minimal të kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Në këto kushte, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues se operatori ekonomik fitues nuk ka paraqitur dokumentacionin përkatës për automjetin apo se nuk disponon certifikatën për transport mallrash për të tretët rezulton qartësisht i pavërtetë dhe i pambështetur në dokumentacionin e administruar në procedurën e prokurimit.

Për rrjedhojë, autoriteti kontraktor vlerëson se operatori ekonomik MUHOPLUS LTD SHPK e ka përmbushur plotësisht kriterin e kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.5 të Kapacitetit Teknik, dlië për këtë arsye pretendimi i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues duhet rrëzuar si i pabazuar në fakte dhe bazën ligjore në fuqi.

5) Përsa i përket ankesës së operatorit ekonomik 4E-COLOR SHPK, me pretendimin se oferta e operatorit ekonomik fitues MUHOPLUS LTD SHPK, e cila është konstatuar si ofertë anomalisht e ulët, nuk është argumentuar dhe justifikuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, ju sqarohet si më poshtë vijon:

Në ankesën e tij, operatori ekonomik ankimues 4E-COLOR SHPK pretendon se oferta e operatorit ekonomik fitues MUHOPLUS LTD SHPK, e cila është konstatuar si ofertë anomalisht e ulët, nuk është argumentuar dhe justifikuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për prokurimin publik. Autoriteti kontraktor e konsideron këtë pretendim të pabazuar si në planin faktik ashtu edhe në atë juridik, pasi nga dokumentacioni i administruar gjatë procedurës së prokurimit rezulton qartë se janë respektuar në mënyrë të plotë dhe rigorozë të gjitha hapat proceduralë të parashikuar në nenin 93 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe në aktet nënligjore përkatëse.

Së pari, nga procesverbali i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave rezulton se në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë dy operatorë ekonomikë, përkatësisht operatori ekonomik 4E-COLOR SHPK, me ofertë ekonomike 15 796 000 lekë pa TVSH, dhe operatori ekonomik MUHOPLUS LTD SHPK, me ofertë ekonomike 13 800 000 lekë pa TVSH. Pas verifikimit të dokumentacionit

administrativ, teknik dhe ekonomik, Komisioni i Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave konstatoi se të dy operatorët ekonomikë i plotësonin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit, si dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Në vijim të procedurës së vlerësimit, Komisioni i Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave, në përputhje me nenin 93 të Ligjit nr.162/2020 dhe nenin 82 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kreu përlllogaritjen për të verifikuar nëse ofertat e paraqitura rezultojn ose jo me çmim anomalisht të ulët. Duke qenë se në procedurë ishin të vlefshme dy oferta, sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit oferta konsiderohet anomalisht e ulët kur është më e ulët se 75% e fondit limit. Nga përlllogaritja e kryer rezultoi se oferta e operatorit ekonomik MUHOPLUS LTD SHPK me vlerë 13 800 000 lekë pa TVSH ishte më e ulët se kufiri i përcaktuar nga formula dhe, për rrjedhojë, u identifikua si ofertë anomalisht e ulët.

Në zbatim të drejtpërdrejtë të nenit 93 pika 1 të Ligjit për Prokurimin Publik, autoriteti kontraktor i kërkoi operatorit ekonomik MUHOPLUS LTD SHPK që të paraqiste me shkrim shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë. Për këtë qëllim, më datë 21.01.2026, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i dërgoi operatorit ekonomik kërkesë zyrtare në SPE (Sistemi i Publikimeve Elektronike), për sqarim të ofertës anomalisht të ulët, duke i kërkuar që brenda afatit ligjor të paraqiste shpjegime të detajuara mbi strukturën e kostos dhe elementët që justifikojn ofertën ekonomike të paraqitur.

Operatori ekonomik MUHOPLUS LTD SHPK, iu përgjigj kësaj kërkesë në mënyrë të rregullt dhe brenda afatit të përcaktuar, duke paraqitur në SPE, më datë 23.01.2026, një shpjegim të detajuar të ofertës së tij ekonomike të shoqëruar me dokumentacionin përkatës justifikues.

Nga përmbajtja e këtij sqarimi rezultoi se operatori ekonomik ka argumentuar ofertën e tij duke iu referuar drejtpërdrejt elementëve të parashikuar në pikën 2 të nenit 93 të Ligjit nr.162/2020, konkretisht në nënpikat a, b dhe c të këtij neni. Në shpjegimet e paraqitura theksohet se çmimi i ofruar është rezultat i kushteve ekonomike të favorshme që operatori ekonomik ka siguruar nëpërmjet bashkëpunimit të drejtpërdrejtë me prodhuesit e pajisjeve, me të cilët ka marrëdhënie bashkëpunimi dhe komunikimi të drejtpërdrejtë për furnizimin e makinerive. Gjithashtu, operatori ekonomik ka paraqitur oferta të prodhuesve përkatës për makineritë e ofruara, të cilat tregojnë çmimet e furnizimit dhe kushtet e shitjes për pajisjet e kërkuara.

Nga dokumentacioni i bashkëngjitur në këtë sqarim rezultoi se janë paraqitur edhe listat e çmimeve të prodhuesve për makineritë objekt prokurimi, përfshirë çmimet për makinerinë e prerjes së letrës 115F+ Program Control Paper Cutter, makinerinë e palosjes ZYHD780D Combination Folding Machine, si dhe makinerinë automatike për vijëzim dhe perforim 9375BSC, të cilat tregojnë çmimet bazë të furnizimit nga prodhuesit dhe kushtet e instalimit dhe trajnimit teknik.

Në analizën e tij, operatori ekonomik ka argumentuar gjithashtu se çmimi i ofruar është ndikuar nga faktorë ekonomikë që lidhen me marrëdhëniet direkte me prodhuesit, kostot e optimizuara të furnizimit dhe bashkëpunimin teknik me partnerët prodhues, çka përbën një nga elementët e

parashikuar në nenin 93 pika 2 shkronja “a” dhe “b” të ligjit, që lidhen me anën ekonomike të procesit të prodhimit dhe me kushtet favorizuese që ofertuesi ka për furnizimin e produkteve.

Pas shqyrtimit të plotë të shpjegimeve të paraqitura nga operatori ekonomik dhe dokumentacionit justifikues të bashkëngjitur, Komisioni i Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave konstatoi se argumentet e paraqitura ishin të mjaftueshme për të provuar se oferta ekonomike e operatorit ekonomik MUHOPLUS LTD SHPK ishte e rregullt në të gjitha elementet e saj dhe e realizueshme nga pikëpamja ekonomike dhe teknike. Për këtë arsye, në përputhje me nenin 93 pika 3 të Ligjit për Prokurimin Publik, komisioni vlerësoi se oferta nuk duhej refuzuar dhe vijoi me klasifikimin e saj si ofertë e vlefshme në procedurën e prokurimit.

Nga sa më sipër rezulton se autoriteti kontraktor ka respektuar plotësisht procedurën e verifikimit të ofertës anomalisht të ulët, duke i kërkuar ofertuesit shpjegime të detajuara, duke shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur dhe duke marrë vendimin përfundimtar vetëm pas analizës së plotë të argumenteve të paraqitura.

Për rrjedhojë, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues se oferta e operatorit ekonomik fitues nuk është argumentuar në përputhje me legjislacionin në fuqi është i pabazuar në fakte dhe në dokumentacionin e administruar gjatë procedurës së prokurimit, dhe si i tillë duhet rrëzuar. [...]”

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 654/3 prot., datë 18.03.2026 me objekt: “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni dhe dokumentacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “4E-COLOR” SHPK”, me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesës pranë KPP-së, në përputhje me nenin 114 të LPP-së, Komisioni i Prokurimit Publik, i kërkoi autoritetit kontraktor informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, shoqëruar me dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria “MUHOPLUS” LTD, që vërteton përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor, objekt ankimimi, sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, të njehsuara me vulën e institucionit si dhe dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria “MUHOPLUS” LTD për të justifikuar ofertën e tij ekonomike.

II.8. Në datën 30.03.2026 është protokolluar në Komsionin e Prokurimit Publik me nr.654/4 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 299/1 prot., datë 26.03.2026 me objekt: “Kthim përgjigje”, bashkëngjitur dokumentacioni i dorëzuar fizikisht nga operatori ekonomik “Muhoplus” LTD si dhe dokumentacioni i procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave.

II.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020, për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga ana e autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “4E-COLOR” SHPK se: **“Se pari dhe ajo që është me kryesorja, rezulton se O.E MUHOPLUS Ltd shpk nuk ka Kapacitetin Teknik dhe Profesional për të realizuar këto kontrata sepse nuk përmbush kriterin kualifikues, për realizimin gjatë 3 (tre) viteve të fundit të furnizimeve të ngjashme për makinerite e shtypit. Operatori ekonomik MUHOPLUS Ltd shpk Tirane gjatë 3(tre) viteve të fundit të aktivitetit të tij në periudhën 2023 2024 2025, nuk ka realizuar asnjë kontratë të ngjashme me makinerite e shtypit të kërkuara në tender. Në kriteret e vecanta të kualifikimit të DST është kërkuar që : - O.E ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se 40% e vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë; a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara ose kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga A.K ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara, b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara. Pra është kërkuar që brenda viteve 2023 2024 2025 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar furnizime të ngjashme me makineri shtypi në një vlerë jo më të ulët se 40% e fondit limit ose në vlerë absolute në shumën prej jo më pak se 7.904.000 leke pa TVSH. Në lidhje me plotësimin e kriterit kualifikues për kryerjen gjatë 3 (tre) viteve të fundit të furnizimeve të ngjashme për makinerite e shtypit nga O.E MUHOPLUS Ltd shpk Tirane, në disponojmë të dhenat zyrtare të shpallura në Buletinin e Prokurimeve Publike të publikuar në sistemin e prokurimit elektronik, ku janë të evidentuara të gjitha kontratat që subjektet kanë realizuar në entet shtetërore për periudhën e viteve 2023 2024 2025. Nga verifikimi i gjithë dhënave që janë të publikuara në Buletinit Zyrtar të APP-se rezulton se: ?Operatori ekonomik MUHOPLUS Ltd shpk Tirane nuk ka realizuar asnjë furnizim të ngjashëm me makineri shtypshkrimi gjatë 3 viteve të fundit; ?Objekti i veprimtarisë së tij lidhet me punime ndërtimore në sektorin e hidrocentraleve, pompave të ujit dhe veprave ujore, kabina elektrike; Konkretisht sipas viteve për periudhën e viteve 2023 2024 2025, bazuar në të dhenat e Buletineve të APP-se, rezulton se MUHOPLUS Ltd shpk Tirane ka fituar kontratat me subjektet shtetërore si më poshtë: NE VITIN 2023 është shpallur fitues: Korrik 2023 Fitues Buletini 64 date 24.07.2023 1. SH.A ALBPETROL REF- 73527-06-23-2023 Blerje lëkundës për QPN Fier dhe QPN Kuçovë , me fond limit 29,600,000 leke; Gusht 2023 Fitues Buletini 69 date 14.08.2023 drejtorja e shërbimit të trupit diplomatik REF- 74695-07-10-2023**

Zëvendësim kaldaja; kryerje punimeve në sistemin e ngrohjes në pallatin nr.6 dhe nr.8 , me fond limit 19, 200, 376 leke; Shtator 2023 Fitues Buletini 80 date 25.09.2023 HEC LANABREGAS SH.A REF- 77437-08-15-2023 Rikonstrukion i Seksionit 6kV në HEC Lanabregas sh.a. (Faza e Dytë) . Fondi limit: 35,866,371 leke; Dhjetor 2023 Fitues Buletini 101 date 18.12.2023 BASHKIA SHIJAK REF- 88171-11-17-2023 F.V Pompë uji për stacionin e pompës Eminas i Vogël . Fondi limit: 2.160.000 leke. Pra sikurse evidentohet ne keto te dhena te sakta te Buletinit te APP-se, rezulton e vertetuar plotesisht se OE MUHOPLUS Ltd shpk, gjate vitit 2023 nuk ka realizuar asnje kontrate te ngjashme me makinerite e shtypi. Paisjet per puset e naftes, kaldajat e pallateve, paisjet e HEC Lanabregas dhe pompat e ujit ne Shijak, nuk jane aspak te ngjashme me Makineritë e kerkuara ne tender, përkatësisht makineria e palosjes, makineria e prerjes dhe ajo e vijëzimit/performimit. Konkluzioni eshte se gjate vitit 2023, me entet shteterore nuk ka realizuar asnje kontrate te ngjashme me makinerite e shtypit te kerkuara ne tender. NE VITIN 2024 eshte shpallur fitues : Shkurt 2024 Fitues Buletini 9 date 19.02.2024 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E OBJEKTEVE PUBLIKE TIRANË REF- 92239-12-27-2023 Blerje materiale elektrike , me fond limit 39 999 991 leke ; Maj 2024 Fitues Fitues Buletini 23 date 07.05.2024 SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SH.A REF- 98647-03-18-2024 Blerje materiale e pajisje elektrike,vegla,pajisje mekanike me fond limit 99.954.000 leke; Shtator 2024 Fitues Buletini 60 date 16.09.2024 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E OBJEKTEVE PUBLIKE TIRANË REF- 16121-08-13-2024 Blerje uniforma dhe veshje speciale , me fond limit 15 997 135 leke; Nentor 2024 Fitues Buletini 78 date 11.11.2024 SH.A Korporata elektroenergjitike shqiptare tiranë REF- 20981-09-20-2024 Rehabilitimi i galerisë së pjerrët në HEC Koman, FV dekovili i ri dhe rikonstrukion i sheshit mes galerisë së pjerrët dhe shpatit të djathtë në digën e Komanit me fond limit 90,435,579 leke; Edhe per vitin 2024, sikurse evidentohet me keto te dhena te sakta te Buletinit te APP-se, rezulton e vertetuar plotesisht se OE MUHOPLUS Ltd shpk, nuk ka realizuar asnje kontrate te ngjashme me makinerite e shtypi. Materialet elektrike, materialet e ujesjellesit Durres, uniformat e veshjet, apo punimet per rikonstrukionin e HEC-it Koman, nuk jane aspak te ngjashme me Makineritë e kerkuara ne tender, përkatësisht makineria e palosjes, makineria e prerjes dhe ajo e vijëzimit/performimit. Konkluzioni eshte se gjate vitit 2024, me entet shteterore nuk ka realizuar asnje kontrate te ngjashme me makinerite e shtypit te kerkuara ne tender. NE VITIN 2025 eshte shpallur fitues : Shkurt 2025 Fitues Buletini 6 date 02.02.2025 Posta Shqiptare REF-33137-12-12-2024 Blerje Pajisje pune për shërbimet (Vula, dare vulosje, kuti postare) , me fond limit 10,509,133 leke; Mars 2025 Fitues Buletini 11 date 03.03.2025 AlbPetrol sh.a Pune REF-34831-12-30-2024 Ndërtim-montim i disa RVM-ve në Qëndrat e Albpetrol sh.a. me fond limit 59,897,190 leke; Prill 2025 Fitues Buletini 20 date 22.04.2025 SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME LUSHNJE SH.A Pune REF- 40401-03-06-2025 Shpim pusi në Libofshë per nevojat e shoqërisë me fond limit 3 550 000 leke; Gusht 2025 Fitues Buletini 42 date 11.08.2025 DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË OSSH SH.A REF- 51837-06-19-2025 Pajisje primare, sekondare dhe pajisje ndihmëse për N.Stacione dhe Linjat TL , me fond limit 199,831,677 leke; Edhe per vitin 2025, sikurse evidentohet me keto te dhena te sakta te Buletinit te APP-se, rezulton e vertetuar plotesisht se OE MUHOPLUS Ltd shpk, nuk ka realizuar asnje

kontrate te ngjashme me makinerite e shtypi. Vulat dhe kutite postare, rikonstruksioni objekteve Albapertol, shpimi i puseve Libofshë, apo paisjet për N.Stacione dhe Linjat TL, nuk jane aspak te ngjashme me Makineritë e kerkuara ne tender, përkatësisht makineria e palosjes, makineria e prerjes dhe ajo e vijëzimit/perforimit. Eshte mese e qarte se edhe gjate vitit 2025, MUHOPLUS Ltd shpk me entet shtetere nuk ka realizuar asnje kontrate te ngjashme me makinerite e shtypit te kerkuara ne tender. Referuar te dhenave te sakta zyrtare te publikuara nga APP-ja, konkluzioni eshte se MUHOPLUS Ltd shpk gjate tre viteve te fundit 2023 2024 2025, nuk ka realizuar me ente shtetere asnje kontrate te ngjashme per makineri shtypi, objekt prokurimi. Gjithashtu ne kontaktuam me pothuaj te gjitha subjektet private shtypshkronja qe operojne ne Shqiperi, me te cilat ne kryejme shitje te makinerive te shtypit, pjese kembimit per makinerite, furnizim me lende te pare per shtypin, servisim te makinerive te shtypit, te cilat na konfirmuan se ne asnje rast nuk kane marre asnje lloj furnizimi nga subjekti MUHOPLUS Ltd shpk Tirane. Megjithate ne po supozojme se ndoshta subjekti MUHOPLUS Ltd shpk, mund te kete paraqitur ne tender fatura shitje per subjekte private te ndonje makinerie per shtypin???? Por menjehere lind pyetja se cila eshte ajo Shtypshkronje Private qe mund te bleje makineri te shtypit nga nje subjekt qe nuk ka asnje lidhje me furnizimin material te industrise se shtypit. Makinerite e shtypit realisht kane nje kosto te shtrenjte, dhe askush nuk ka para te teperta qe ti besoje nje subjekti qe nuk ka eksperiencen e duhur te kesaj fushe specifike dhe te vecante, qe nuk disponon pjese kembimi ne rast avarie dhe nuk eshte marre asnjehere me servisimin e makinerive. Ne mendojme se nese OE MUHOPLUS Ltd, ka paraqitur fatura shitje per makineri shtypi te periudhes 202320242025, keto fatura shitje ose jane fiktive ose jane te fallsifikuara. Ne kete rast eshte detyrim ligjor i K.Sh.Ankesave, per te bere verifikim te ketij dokumentacioni. Eshte mese e qarte se MUHOPLUS Ltd shpk Tirane, nuk permbush kapacitetin teknik dhe profesional, sepse rezulton qe kriteri i përvojës së ngjashme nga operatori ekonomik MUHOPLUS Ltd shpk nuk është përmbushur, dhe vendimi per kualifikim nuk qendron.” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.1 në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se 40% e vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë; a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara, b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas

kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.1.2. Në shtojcën 6 "Formulari i specifikimeve teknike" të dokumentave të tenderit të publikuara në SPE, është parashikuar si vijon:

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;*
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;*
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.*

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

1. Makineri shtypi për palosje gjysmë automatike

- Përmasa maksimale e fletës: 780 x 1160 mm ($\pm 5\%$)
- Përmasa minimale e fletës: 150 x 200 mm
- Gjerësia minimale e fletës për palosje paralele: 55 mm
- Shpejtësia maksimale e palosjes: 230 m/min ($\pm 5\%$)
- Përmasa minimale e fletës: 150 x 200 mm
- Frekuenca maksimale e thikës së palosjes: 350 goditje/min
- Trashësia e letrës: 40–120 g/m²
- Fuqia e makinerisë: 7.8 Kë ($\pm 5\%$)
- Përmasa minimale e fletës: 150 x 200 mm
- Përmasat totale (Gjatësi x Gjerësi x Lartësi), minimale: 5400 x 2120 x 1630 mm ($\pm 5\%$)
- Përmasa minimale e fletës: 150 x 200 mm
- Peshë neto e makinerisë: minimum 2400 kg ($\pm 5\%$)

Opsione të kërkuara:

- Minimum katër pllaka palosëse me bllokim (buckle plates) dhe tre thika të komanduara, të cilat mundësojnë mekanikisht palosje paralele dhe të kryqëzuara, me mundësi shtesë për palosje të brendshme ose të jashtme në format 32 (formate të standardizuara të palosjes), si dhe palosje të dyfishta të brendshme në format 32 (ose 24 formate të standardizuara).
- Pajisje ushqyese ndarëse fletësh (sheet-separating feeder) me performancë të lartë dhe monitorim automatik.
- Funkcion afishimi të gabimeve për diagnostikim dhe zgjidhje defektesh.
- Sistem i avancuar për detektimin automatik të fletëve dyshe dhe të bllokuara.
- Opsione për palosje, vijëzim, perforim dhe prerje sipas kërkesës.
- Sistem automatik për monitorimin dhe kontrollin e lartësisë së grumbullit të letrës në dalje.
- Sistem special shtypjeje të letrës që siguron transport të saktë dhe operim të përshtatshëm.
- Sistem elektrik dhe punë të kontrolluar nga programues automatik, me ekran të madh me prekje për futjen e parametrave.

2. Makineri shtypi për prerje letre

- Gjerësia e prerjes: 115 cm
- Lartësia maksimale e prerjes pa përdorimin e pllakës ndihmëse: 16.5 cm
- Thellësia maksimale e prerjes: 115 cm
- Thellësia minimale e prerjes pa përdorimin e pllakës ndihmëse: 2.5 cm
- Gjatësia e zgjeruar e tavolinës së punës: 73 cm ($\pm 5\%$)
- Lartësia e tavolinës së punës: 88–92 cm ($\pm 5\%$)
- Gjerësia e makinerisë (me tavolina anësore): 266 cm ($\pm 5\%$)
- Gjerësia totale e tavolinës së punës: 226 cm ($\pm 5\%$)
- Shpejtësia e prerjes: 45 r/min

- Presioni maksimal mbi letër: 40,000 N
- Fuqia e motorit kryesor: 4 kË (±5%)
- Motori për ushqimin e letrës: 0.75 kË (±5%)
- Pompa e ajrit: 0.75 kË (±5%)
- Pesha e makinerisë: 4000 kg (±5%)
- Përmasat totale (Gjatësi x Gjerësi x Lartësi): 255 x 160 x 215 cm (±5%)

Opsione të kërkuara:

- Pajisje sigurie infra të kuqe me sensorë fotoelektrikë dhe butona sigurie për përdorim me të dyja duart.
- Pajisje sigurie për shtratin e thikës, mbrojtje nga mbingarkesa gjatë prerjes dhe pajisje automatike sigurie për rikthim.
- Ekran me prekje me ngjyra, **jo më të vogël se 15 inç.**
- Sistem PLC për monitorimin e gjithë zbatimit mekanik.
- Pajisje mbrojtëse IR për prerje më të sigurt, sistem optik për rreshtimin e thikës, butona për operim me dy duar dhe cikël të vetëm prerjeje.
- Funksion vetë-diagnostikimi i gabimeve dhe shfaqje e mënyrës së funksionimit.

3. Makineri shtypi për vijëzim dhe perforim

- Madhësia e futjes së letrës (Infeed): 210 x 210 mm – 370 x 900 mm (±5%)
- Madhësia e daljes së letrës (Outfeed): 50 x 48 mm – 370 x 1200 mm (±5%)
- Pesha e letrës: 150–400 gsm
- Kapaciteti i ngarkimit: 150 mm
- Shpejtësia e punës: 24 copë/min (A4, prerje në 4 anë + 1 linjë palosjeje); 220 kartela/min (24 copë për herë) (±5%)
- Shenja regjistrimi: kompensim për devijimin e figurës në boshtin X dhe Y
- Detektimi i fletëve të dyfishta: sensor ultrasonik me sistem hedhjeje të fletës së tepërt
- Gjerësia e linjës së palosjes (Crease): standard 1.0 mm (2 copë)
- Rregullimi i thellësisë së palosjes: automatik sipas trashësisë së letrës
- Palosje dhe perforim në një kalim: deri në 32 linja, 2 herë secila (64 linja gjithsej)
- Pritje (Slitting): 6 thika me rregullim automatik (standard)
- Prerje: deri në 32 herë në një kalim
- Saktësia: ±0.2 mm
- Kompensim për tkurrje ose shtrirje të figurës: në boshtin X dhe Y
- Kontrolli dhe ekрани: ekran me prekje me ngjyra, **jo më të vogël se 9 inç**
- Perforim i pjesshëm standard: rruga transversale 32 x 8 seksione; rruga lineare 2 linja x 16 seksione
- Rregullimi i pjerrësisë (Skeë): automatik përmes softuerit

- *Moduli i palosjes/performimit: 2*

Në shtojcën 7 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit” të dokumentave të tenderit të mësipërm të publikuara në SPE, rezulton se është parashikuar si vijon:

Shtojca 7.

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Njësia	Sasia
1	Makineri shtypi për palosje gjysëm automatike	copë	1
2	Makineri shtypi për prerje letre	copë	1
3	Makineri shtypi për vijëzim, performim	copë	1

Afatet e lëvrimit:

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Njesia	Sasia	Destinacioni	Afati i lëvrimit
1	Makineri shtypi për palosje gjysëm automatike	copë	1	SHLV	90 ditë
2	Makineri shtypi për prerje letre	copë	1	SHLV	90 ditë
3	Makineri shtypi për vijëzim, performim	copë	1	SHLV	90 ditë

SHËNIM: Afati për lëvrimin e mallrave për çdo minikontratë do të jetë brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Shpjegim i termave: SHLV → Shtypshkronja e letrave me vlerë

III.1.3. Referuar procesverbalit “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim” rezulton se, nga ana e njësisë së prokurimit, parashikimi i kriterit të sipërcituar, është argumentuar si më poshtë vijon:

[...] **Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 4 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në kushtet kur kjo procedurë prokurimi klasifikohet procedurë e hapur. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët

ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik. Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

III.1.4. Në kthimin e përgjigjes lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues autoriteti kontraktor, argumenton se: “1)Përsa i përket ankesës së operatorit ekonomik 4E-COLOR SHPK, me pretendimin që operatorit ekonomik fitues nuk ka kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se 40% e vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ju sqarojmë si më poshtë vijon: Operatori ekonomik ankimues pretendon se operatorit ekonomik i shpallur fitues nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.1 të Kapacitetit Teknik, sipas Shtojcës 8 të Dokumenteve Standarde të Tenderit, me argumentin se ky operator nuk ka paraqitur furnizime të njëjta me objektin e kontratës dhe, për pasojë, nuk mund të realizojë kontratën. Autoriteti kontraktor e konsideron këtë pretendim të pabazuar si në aspektin ligjor ashtu edhe në atë teknik. **Së pari**, nga pikëpamja ligjore, kriteri i përcaktuar në dokumentet e tenderit kërkon paraqitjen e furnizimeve të ngjashme, dhe jo furnizime identike me objektin e prokurimit. Legjislacioni në fuqi për prokurimin publik, si dhe praktika e konsoliduar e autoriteteve kontraktore dhe e Komisionit të Prokurimit Publik, nuk kërkon në asnjë rast që operatorit ekonomik të ketë realizuar kontrata identike me objektin e prokurimit, por vetëm kontrata që dëshmojnë përvojë të krahasueshme në natyrë, kompleksitet dhe funksionalitet. Kjo qasje është në përputhje edhe me logjikën e përgjithshme të së drejtës së prokurimit publik, e cila synon të verifikojë kapacitetin real profesional dhe teknik të operatorit ekonomik, dhe jo të kufizojë konkurrencën duke kërkuar përvoja identike që në praktikë do të reduktonin padrejtësisht numrin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në treg. Për më tepër, interpretimi i bërë nga operatorit ekonomik ankimues, sipas të cilit kërkohen furnizime të njëjta, përbën një interpretim të zgjeruar dhe të pabazuar të kriterit të vendosur në dokumentet e tenderit, duke tentuar të barazojë dy koncepte juridikisht dhe teknikisht të ndryshme, përkatësisht “furnizime të ngjashme” dhe “furnizime identike”. **Së dyti**, edhe nga pikëpamja teknike, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron. Makineritë objekt i kësaj procedure prokurimi, sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit, nuk përbëjnë makineri të mirëfillta shtypshkrimi, por pajisje që mbështesin dhe asistojnë procesin e zinxhirit të prodhimit, duke qenë pjesë e sistemit teknik që mundëson funksionimin dhe automatizimin e proceseve industriale. Në praktikën industriale dhe teknologjike, pajisje të tilla konsiderohen pajisje ndihmëse ose komponentë funksionalë të sistemeve teknologjike, të cilat përdoren në procese të ndryshme prodhimi dhe nuk janë të kufizuara vetëm në industrinë e shtypshkrimit. Në këtë kuptim, përvoja e operatorit ekonomik në furnizimin e pajisjeve teknike të ngjashme, të cilat kryejnë funksione të krahasueshme teknologjike dhe operacionale, përbën një tregues të mjaftueshëm për të vërtetuar kapacitetin e tij teknik për realizimin e kontratës. Në këtë drejtim, operatorit ekonomik i shpallur fitues ka paraqitur dokumentacion që provon realizimin e një sërë furnizimesh të ngjashme me natyrë teknike të krahasueshme, ndër të cilat përfshihen furnizime me pajisje elektromekanike, pompa industriale,

*panele elektrike dhe komponentë të sistemeve teknologjike. Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton, ndër të tjera, furnizimi me pajisje teknike dhe elektromekanike si elektropompa industriale, inverterë dhe panele elektrike të kontrollit, të cilat janë komponentë tipikë të sistemeve të automatizimit dhe kontrollit industrial. Po kështu, në furnizimet e realizuara përfshihen edhe sisteme dhe komponentë teknikë si panel elektrik me soft-starter, motorë elektrikë dhe pajisje të tjera elektroteknike, të cilat përbëjnë elementë thelbësorë të sistemeve teknologjike industriale. Gjithashtu, dokumentacioni i paraqitur provon realizimin e furnizimeve me pompa centrifugale, pompa zhytëse dhe panele kontrolli industriale, të cilat janë pajisje me karakteristika të ngjashme funksionale dhe teknike me pajisjet që përdoren në procese të ndryshme industriale. Në këtë kuadër, përvoja e dokumentuar e operatorit ekonomik fitues dëshmon qartë se ai ka realizuar furnizime që për nga natyra teknologjike, kompleksiteti teknik dhe funksionaliteti industrial janë te krahasueshme me objektin e kontratës. **Së treti**, edhe nga këndvështrimi i së drejtës tregtare dhe civile, kontratat e furnizimit nuk klasifikohen sipas identitetit absolut të mallrave të furnizuara, por sipas natyrës ekonomike dhe teknike të veprimtarisë së ushtruar nga operatori ekonomik. Në praktikën e marrëdhënieve tregtare, një operator ekonomik që furnizon pajisje dhe sisteme teknike të një fushe të caktuar industriale konsiderohet se zotëron kapacitetin profesional për furnizime të ngjashme brenda kategorive të përafërta teknologjike, edhe në rastet kur specifikimet konkrete të pajisjeve ndryshojnë. Në përfundim, nga analiza e dokumentacionit të paraqitur dhe nga interpretimi i drejtë i kërkesës së përcaktuar në pikën 2.3.1 të Kapacitetit Teknik, rezulton se: dokumentet e tenderit kërkojnë furnizime të ngjashme, dhe jo furnizime identike; operatori ekonomik i shpallur fitues ka paraqitur dokumentacion që provon realizimin e furnizimeve të ngjashme; përvoja e paraqitur dëshmon kapacitetin teknik dhe profesional për realizimin e kontratës. Për rrjedhojë, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues se operatori ekonomik fitues nuk plotëson kriterin e kapacitetit teknik të pikës 2.3.1 sipas Shtojcës 8 të Dokumenteve Standarde të Tenderit, nuk qëndron dhe duhet rrëzuar si i pabazuar në fakte dhe bazën ligjore në fuqi.”*

III.1.5. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik, në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik ““MUHOPLUS” LTD, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

1. Faturë elektronike me Nr. 8/2024, datë 16.01.2024, me blerës A.K.M me vlerë 10 620 EUR lekë pa tvsh. Kjo faturë, në përshkrimin e mallit ka artikujt: elektropompë zhytëse, electromotor zhytës, panel elektrik, kabëll elektrik, xhunto, tel bakri
2. Faturë elektronike me Nr. 2/2021, datë 28.12.2021, me blerës Alb-Konstruksion SHPK, me vlerë 1.864.000 lekë pa tvsh. Kjo faturë, në përshkrimin e mallit ka artikujt: pompë centrifugale, pompë zhytëse, panel lëshimi.
3. Faturë elektronike me Nr. 10/2024, datë 18.01.2024, me blerës Albpetrol SHA me vlerë 13.680.000 lekë pa TVSh. Përshkrimi i mallit është si vijon: sisteme lëkundës.
4. Faturë elektronike me Nr. 9/2024, datë 18.01.2024, me blerës Albpetrol SHA me vlerë 15.100.000 lekë pa TVSh. Përshkrimi i mallit është si vijon: sisteme lëkundës.

5. Faturë elektronike me Nr. 33/2022, datë 10.11.2022, me blerës Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit me vlerë 800.000 lekë pa TVSh. Përshkrimi i mallit është si vijon: depozite uji, elektropompe centrifugale.
6. Faturë elektronike me Nr. 3/2021, datë 09.09.2021, me blerës Arkostudio SHPK me vlerë 18.426.619 lekë pa TVSh. Përshkrimi i mallit është si vijon: rrjet TU me kablo me vetembajtje, rikonstruksion kabine elektrike, kalimi I ngarkeses se kabinave elektrike nga fideri 4 në fiderin 2.
7. Faturë elektronike me Nr. 1/2021, datë 09.11.2021, me blerës Bashkia Dropull me vlerë 680.000 lekë pa TVSh. Përshkrimi i mallit është si vijon: FV Saracineska; FV valvola celiku; FV adaptor, brryla; FV panel elektrik; montim pompe; elektro pompe centrifugale.
8. Faturë elektronike me Nr. 20/2022, datë 17.05.2022, me blerës Bashkia Dropull me vlerë 500.000 lekë pa TVSh. Përshkrimi i mallit është si vijon: FV electromotor; FV kabell celiku; FV muffle, FV kapikorta; rikonstruksion paneli; shërbim me autovinc.
9. Faturë elektronike me Nr. 12/2024, datë 25.01.2024, me blerës Bashkia Shijak me vlerë 1.950.000 lekë pa TVSh. Përshkrimi i mallit është si vijon: FV elektropompe; FV panel komandimi; FV saracineske; FV valvol moskthimi; FV fillaxhe për saldim; V bulona celiku, pinime saldimi.
10. Faturë elektronike me Nr. 45/2022, datë 09.12.2022, me blerës GIZ Office Albania me vlerë 5.244.200 lekë pa TVSh. Përshkrimi i mallit është si vijon: SI plastic tub; SI EC plastic kasete; SI CU control cable; FV përcjellës; SI PPV conductor; SI automat termo; SI plug outside ëall; SI sëitchës; LED illuminator; LED projector; SI poëder fire; SI manometer; SI ritern valve; SI valves; SI pipe parts; SI bende 90 degrees; SI register; SI filter; SI air valve; SI bend; SI adapter; SI TU cable; SI release panel; SI el/vertical pumps; control levelsëitch system ëater; automatic stop system.
11. Faturë elektronike me Nr. 47/2022, datë 15.12.2022, me blerës GIZ Office Albania me vlerë 4.554.200 lekë pa TVSh. Përshkrimi i mallit është si vijon: SI plastic tub; SI EC plastic kasete; SI CU control cable; FV përcjellës; SI PPV conductor; SI automat termo; SI plug outside ëall; SI sëitchës; LED illuminator; LED projector; SI poëder fire; SI manometer; SI ritern valve; SI valves; SI pipe parts; SI bende 90 degrees; SI register; SI filter; SI air valve; SI bend; SI adapter; SI TU cable; SI release panel; SI el/vertical pumps;
12. Faturë elektronike me Nr. 28/2023, datë 23.11.2023, me blerës Agjencia Shterore për të Drejtat dhe Mbrojtjes e Fëmijës me vlerë 41.667 lekë pa TVSh. Përshkrimi i mallit është si vijon: goma; bateri.
13. Faturë elektronike me Nr. 29/2023, datë 23.11.2023, me blerës Agjencia Shterore për të Drejtat dhe Mbrojtjes e Fëmijës me vlerë 50.000 lekë pa TVSh. Përshkrimi i mallit është si vijon: goma; bateri.

- 14.** Faturë elektronike me Nr. 20/2023, datë 18.08.2023, me blerës HEC Lanabregas me vlerë 382.500 lekë pa TVSh. Përshkrimi i mallit është si vijon: karikues baerie, pompë zhytëse; celës hidraulik; ngrohësa; rele; bolier; korrëse bari; traspalete; tavoline mekaniku; megger; shkalle alumini; lazer 4D; thermostat kuzhinete.
- 15.** Faturë elektronike me Nr. 26/2023, datë 23.11.2023, me blerës MASTELA me vlerë 10.500 EUR lekë pa TVSh. Përshkrimi i mallit është si vijon: elektropompe zhytëse; electromotor; panel elektrik; tubo celiku; flanaxhe celiku; reduksion për tuba celiku.
- 16.** Faturë elektronike me Nr. 16/2024, datë 08.04.2024, me blerës Shoqëria Rajonale e Ujesjellës Kanalizeve Durres me vlerë 810.000 lekë pa TVSh. Përshkrimi i mallit është si vijon: bronxina; busull; helika; aks pompe; kit guarnicione oring.
- 17.** Faturë elektronike me Nr. 7/2024, datë 10.01.2024, me blerës NG Structures me vlerë 791.016 lekë pa TVSh. Përshkrimi i mallit është si vijon: kaseta metalike per panele; Automat ABB.
- 18.** Faturë elektronike me Nr. 2/2022, datë 10.03.2022, me blerës Provinca Franceskane Zoja NUNCIATE me vlerë 30.032 EUR pa TVSh. Përshkrimi i mallit është si vijon: FV elektropompe.
- 19.** Faturë elektronike me Nr. 27/2023, datë 24.10.2023, me blerës Dega Renco SPA Albania me vlerë 19.720 EUR pa TVSh. Përshkrimi i mallit është si vijon: Calpeda circulation pump.
- 20.** Faturë elektronike me Nr. 15/2023, datë 11.07.2023, me blerës Dega Renco SPA Albania me vlerë 19.720 EUR pa TVSh. Përshkrimi i mallit është si vijon: Uninterruptible poëer supplies.
- 21.** Faturë elektronike me Nr. 6/2024, datë 10.01.2024, me blerës Shendelli SHPK me vlerë 588.984 lekë pa TVSh. Përshkrimi i mallit është si vijon: kaseta metalike per panele; automat ABB.
- 22.** Faturë elektronike me Nr. 13/2024, datë 13.03.2024, me blerës Shendelli SHPK me vlerë 753.302 lekë pa TVSh. Përshkrimi i mallit është si vijon: FV VDF inverter per pompa
- 23.** Faturë elektronike me Nr. 23/2023, datë 01.09.2023, me blerës Ujesjelles Kanalizime me vlerë 560.000 lekë pa TVSh. Përshkrimi i mallit është si vijon: FV pajisje leshimi komandimi per elektropompe
- 24.** Faturë elektronike me Nr. 24/2023, datë 01.09.2023, me blerës Ujesjelles Kanalizime me vlerë 790.000 lekë pa TVSh. Përshkrimi i mallit është si vijon: FV elektromotori
- 25.** Faturë elektronike me Nr. 20/2024, datë 03.06.2024, me blerës Shendelli SHPK me vlerë 853.600 lekë pa TVSh. Përshkrimi i mallit është si vijon: furnizim me elektropompe

26. Faturë elektronike me Nr. 21/2024, datë 03.06.2024, me blerës NG Structures me vlerë 2.158.098 lekë pa TVSh. Përshkrimi i mallit është si vijon: furnizim me elektropompe; furnizim invertera pompa.
27. Faturë elektronike me Nr. 30/2024, datë 14.11.2024, me blerës Arteo 2018 me vlerë 380.000 lekë pa TVSh. Përshkrimi i mallit është si vijon: Furnizim soft starter
28. Faturë elektronike me Nr. 18/2024, datë 22.04.2024, me blerës Alba Konstruksion SHPK me vlerë 26.150 EUR pa TVSh. Përshkrimi i mallit është si vijon: pompe zhytëse; bazamneti I montimit anesor; FV soft starter.
29. Faturë me Nr. 2/2021, datë 28.12.202124, me blerës Alb Konstruksion SHPK me vlerë 1.864.000 lekë pa TVSh. Përshkrimi i mallit është si vijon: pompe centrifugale uji; pompe zhytëse uji; panel leshimi.
30. Faturë elektronike me Nr. 23/2025, datë 26.11.2025, me blerës Dega Renco SPA Albania me vlerë 8.860 EUR pa TVSh me pershkrimin: Digital Excitation Control System.
31. Kontrate furnizimi date 18.09.2023 me bleres shoqërinë “Albpetrol” SHA me object: “Blerje lekundës për QPN Fier dhe QPN Kucove” me vlerë 28.780.000 lekë pa TVSH, shoqëruar me Formularin e ofertës; listn e cmimeve; formularin e specifikimeve teknike; Faturën elektronike me Nr. 10/2024, datë 18.01.2024, me blerës Albpetrol SHA me vlerë 13.680.000 lekë pa TVSh. Përshkrimi i mallit është si vijon: sisteme lëkundës; Faturë elektronike me Nr. 9/2024, datë 18.01.2024, me blerës Albpetrol SHA me vlerë 15.100.000 lekë pa TVSh, Përshkrimi i mallit është si vijon: sisteme lëkundës.III.1.5. Referuar procesverbalit

III.1.6. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efektivitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

III.1.7. Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 8 3.

Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.8. Neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. 9 Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.1.9. Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së, përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.1.10. Në nenin 40 *“Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”* pika 4, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, parashikohet se: *“4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre vjetëve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”*

III.1.11. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 *“Për prokurimin publik”* ka për detyrë të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.12. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “MUHOPLUS” LTD, në përmbushje të kriterit për përvojat e mëparshme, KPP vlerëson se, së pari, norma juridike duhet të interpretohet e më pas të gjykohet, kjo për të analizuar në thelb ratio legis, kuptimin e drejtë të saj. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar diskrecionin e autoritetit kontraktor të kërkimit të dëshmimeve për përvojën e mëparshme, me synim për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Pra e drejta e dhënë nga ligji lidhet ngushtësisht me garantimin e autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik disponon dëshmi të përvojës së mëparshme për të realizuar kontratën sipas kërkesave të dokumenteve të tenderit.

Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për mallra ligjvënësi në nenin 40, pika 4 të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, të ndryshuar, ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e vërtetimeve të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, dhe në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme.

KPP konstaton, se në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 të Shtojcës 8 të dokumentave të tenderit të sipërpërmendur, autoriteti kontraktor ka përcaktuar se *operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se 40% e vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë; a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara, b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

Në përmbushje të kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.1 të Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit të sipërpërmendur, operatori ekonomik “MUHOPLUS” LTD ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik Faturë elektronike me Nr. 8/2024, datë 16.01.2024, me blerës A.K.M me vlerë 10 620 EUR lekë pa tvsh, me përshkrimin e mallit: elektropompë zhytëse, electromotor zhytës, panel elektrik, kabëll elektrik, xhunto, tel bakri; Faturë elektronike me Nr. 2/2021, datë 28.12.2021, me

blerës Alb-Konstruksion SHPK, me vlerë 1.864.000 lekë pa tvsh, me përshkrimin e mallit: pompë centrifugale, pompë zhytëse, panel lëshimi; Faturë elektronike me Nr. 10/2024, datë 18.01.2024, me blerës Albpetrol SHA me vlerë 13.680.000 lekë pa TVSh me përshkrimin e mallit: sisteme lëkundës; Faturë elektronike me Nr. 9/2024, datë 18.01.2024, me blerës Albpetrol SHA me vlerë 15.100.000 lekë pa TVSh me përshkrimin e mallit: sisteme lëkundës; Faturë elektronike me Nr. 33/2022, datë 10.11.2022, me blerës Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit me vlerë 800.000 lekë pa TVSh me përshkrimin e mallit: depozite uji, elektropompe centrifugale; Faturë elektronike me Nr. 3/2021, datë 09.09.2021, me blerës Arkostudio SHPK me vlerë 18.426.619 lekë pa TVSh me përshkrimin e mallit: rrjet TU me kablo me vetembajtje, rikonstruksion kabine elektrike, kalimi I ngarkeses se kabinave elektrike nga fideri 4 në fiderin 2; Faturë elektronike me Nr. 1/2021, datë 09.11.2021, me blerës Bashkia Dropull me vlerë 680.000 lekë pa TVSh me përshkrimin e mallit: FV Saracineska; FV valvola celiku; FV adaptor, brryla; FV panel elektrik; montim pompe; elektro pompe centrifugale; Faturë elektronike me Nr. 20/2022, datë 17.05.2022, me blerës Bashkia Dropull me vlerë 500.000 lekë pa TVSh me përshkrimin e mallit: FV electromotor; FV kabell celiku; FV muffle, FV kapikorta; rikonstruksion paneli; shërbim me autovinc; Faturë elektronike me Nr. 12/2024, datë 25.01.2024, me blerës Bashkia Shijak me vlerë 1.950.000 lekë pa TVSh me përshkrimin e mallit: FV elektropompe; FV panel komandimi; FV saracineske; FV valvol moskthimi; FV fllaxhe për saldimit; V bulona celiku, pinime saldimit; Faturë elektronike me Nr. 45/2022, datë 09.12.2022, me blerës GIZ Office Albania me vlerë 5.244.200 lekë pa TVSh me përshkrimin e mallit: SI plastic tub; SI EC plastic kasete; SI CU control cable; FV përcjellës; SI PPV conductor; SI automat termo; SI plug outside ëall; SI sëitches; LED illuminator; LED projector; SI poëder fire; SI manometer; SI ritern valve; SI valves; SI pipe parts; SI bende 90 degrees; SI register; SI filter; SI air valve; SI bend; SI adapter; SI TU cable; SI release panel; SI el/vertical pumps; control levelsëitch system ëater; automatic stop system; Faturë elektronike me Nr. 47/2022, datë 15.12.2022, me blerës GIZ Office Albania me vlerë 4.554.200 lekë pa TVSh me përshkrimin e mallit: SI plastic tub; SI EC plastic kasete; SI CU control cable; FV përcjellës; SI PPV conductor; SI automat termo; SI plug outside ëall; SI sëitches; LED illuminator; LED projector; SI poëder fire; SI manometer; SI ritern valve; SI valves; SI pipe parts; SI bende 90 degrees; SI register; SI filter; SI air valve; SI bend; SI adapter; SI TU cable; SI release panel; SI el/vertical pumps; Faturë elektronike me Nr. 28/2023, datë 23.11.2023, me blerës Agjencia Shterore për të Drejtat dhe Mbrojtjes e Fëmijës me vlerë 41.667 lekë pa TVSh me përshkrimin e mallit: goma; bateri; Faturë elektronike me Nr. 29/2023, datë 23.11.2023, me blerës Agjencia Shterore për të Drejtat dhe Mbrojtjes e Fëmijës me vlerë 50.000 lekë pa TVSh me përshkrimin e mallit: goma; bateri; Faturë elektronike me Nr. 20/2023, datë 18.08.2023, me blerës HEC Lanabregas me vlerë 382.500 lekë pa TVSh me përshkrimin e mallit: karikues baerie, pompë zhytëse; celës hidraulik; ngrohësa; rele; bolier; korrëse bari; traspalete; tavoline mekaniku; megger; shkalle alumini; lazer 4D; thermostat kuzhinete; Faturë elektronike me Nr. 26/2023, datë 23.11.2023, me blerës MASTELA me vlerë 10.500 EUR lekë pa TVSh me përshkrimin e mallit: elektropompe zhytëse; electromotor; panel elektrik; tubo celiku; fllanxhe celiku; reduksion për tuba celiku; Faturë elektronike me Nr. 23/2025, datë 26.11.2025, me blerës Dega Renco SPA

Albania me vlerë 8.860 EUR pa TVSh me pershkrimin: Digital Excitation Control System; Faturë elektronike me Nr. 16/2024, datë 08.04.2024, me blerës Shoqëria Rajonale e Ujesjellës Kanalizave Durrës me vlerë 810.000 lekë pa TVSh me përshkrimin e mallit: bronxina; busull; helika; aks pompe; kit guarnicione oring; Faturë elektronike me Nr. 7/2024, datë 10.01.2024, me blerës NG Structures me vlerë 791.016 lekë pa TVSh me përshkrimin e mallit: kasete metalike per panele; Automat ABB; Faturë elektronike me Nr. 2/2022, datë 10.03.2022, me blerës Provinca Franceskane Zoja NUNCIATE me vlerë 30.032 EUR pa TVSh me përshkrimin e mallit: FV elektropompe; Faturë elektronike me Nr. 27/2023, datë 24.10.2023, me blerës Dega Renco SPA Albania me vlerë 19.720 EUR pa TVSh me përshkrimin e mallit: Calpeda circulation pump; Faturë elektronike me Nr. 15/2023, datë 11.07.2023, me blerës Dega Renco SPA Albania me vlerë 19.720 EUR pa TVSh me përshkrimin e mallit: Uninterruptible poëer supplies; Faturë elektronike me Nr. 6/2024, datë 10.01.2024, me blerës Shendelli SHPK me vlerë 588.984 lekë pa TVSh me përshkrimin e mallit: automat ABB; Faturë elektronike me Nr. 13/2024, datë 13.03.2024, me blerës Shendelli SHPK me vlerë 753.302 lekë pa TVSh me përshkrimin e mallit: FV VDF inverter per pompa; Faturë elektronike me Nr. 23/2023, datë 01.09.2023, me blerës Ujesjelles Kanalizime me vlerë 560.000 lekë pa TVSh me përshkrimin e mallit: FV pajisje leshimi komandimi per elektropompe; Faturë elektronike me Nr. 24/2023, datë 01.09.2023, me blerës Ujesjelles Kanalizime me vlerë 790.000 lekë pa TVSh me përshkrimin e mallit: FV elektromotori; Faturë elektronike me Nr. 20/2024, datë 03.06.2024, me blerës Shendelli SHPK me vlerë 853.600 lekë pa TVSh me përshkrimin e mallit: furnizim me elektropompe; Faturë elektronike me Nr. 21/2024, datë 03.06.2024, me blerës NG Structures me vlerë 2.158.098 lekë pa TVSh me përshkrimin e mallit: furnizim me elektropompe; furnizim invertera pompa; me përshkrimin e mallit; Faturë elektronike me Nr. 30/2024, datë 14.11.2024, me blerës Arteo 2018 me vlerë 380.000 lekë pa TVSh: Furnizim soft starter; Faturë elektronike me Nr. 18/2024, datë 22.04.2024, me blerës Alba Konstruksion SHPK me vlerë 26.150 EUR pa TVSh me përshkrimin e mallit: pompe zhytëse; bazamneti i montimit anesor; FV soft starter; Faturë me Nr. 2/2021, datë 28.12.2021, me blerës Alb Konstruksion SHPK me vlerë 1.864.000 lekë pa TVSh me përshkrimin e mallit: pompe centrifugale uji; pompe zhytëse uji; panel leshimi; Kontrate furnizimi date 18.09.2023 me blerës shoqërinë “Albpetrol” SHA me object: “Blerje lekundës për QPN Fier dhe QPN Kucove” me vlerë 28.780.000 lekë pa TVSH, shoqëruar me Formularin e ofertës; listën e cmimeve; formularin e specifikimeve teknike; Faturën elektronike me Nr. 10/2024, datë 18.01.2024, me blerës Albpetrol SHA me vlerë 13.680.000 lekë pa TVSh. Përshkrimi i mallit është si vijon: sisteme lëkundës; Faturë elektronike me Nr. 9/2024, datë 18.01.2024, me blerës Albpetrol SHA me vlerë 15.100.000 lekë pa TVSh, Përshkrimi i mallit është si vijon: sisteme lëkundës.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “MUHOPLUS” LTD, KPP konstaton, se nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të këtyre faturave, duke nisur nga përshkrimi i mallit të faturave elektronike, rezulton, se eksperiencat e mëparshme të shoqërisë në fjalë nuk janë të ngjashme me objektin e prokurimit për asnjërën prej zërave përkatës. Konkretisht

nuk janë të ngjashme me objektin e prokurimit zërat e furnizimeve: elektropompë zhytëse, electromotor zhytës, panel elektrik, kabëll elektrik, xhunto, tel bakri, pompë centrifugale, pompë zhytëse, panel lëshimi; sisteme lëkundës; depozite uji, elektropompe centrifugale, rrjet TU me kabullo me vetembajtje, Saracineska; valvola celiku; adaptor, brryla, elektro pompe centrifugale; electromotor; kabell celiku; muffle, kapikorta; panel komandimi; FV saracineske; FV valvol moskthimi; fllaxhe për saldim; bulona celiku, pinime saldimi; SI plastic tub; SI EC plastic kasete; SI CU control cable; përcjellës; SI PPV conductor; SI automat termo; SI plug outside ëall; SI sëitches; LED illuminator; LED projector; SI poëder fire; SI manometer; SI ritern valve; SI valves; SI pipe parts; SI bende 90 degrees; SI register; SI filter; SI air valve; SI bend; SI adapter; SI TU cable; SI release panel; SI el/vertical pumps; control levelsëitch system ëater; automatic stop system; SI plastic tub; SI EC plastic kasete; SI CU control cable; FV përcjellës; SI PPV conductor; SI automat termo; SI plug outside ëall; SI sëitches; LED illuminator; LED projector; SI poëder fire; SI manometer; SI ritern valve; SI valves; SI pipe parts; SI bende 90 degrees; SI register; SI filter; SI air valve; SI bend; SI adapter; SI TU cable; SI release panel; SI el/vertical pumps; goma; bateri; goma; bateri; karikues baerie, pompë zhytëse; celës hidraulik; ngrohësa; rele; bolier; korrëse bari; traspaletë; tavoline mekaniku; megger; shkalle alumini; lazer 4D; thermostat kuzhinete; elektropompe zhytëse; electromotor; panel elektrik; tubo celiku; fllanxhe celiku; reduksion për tuba celiku; bronxina; busull; helika; aks pompe; kit guarnicione oring; kaseta metalike për panele; Automat ABB; FV elektropompe; Calpeda circulation pump; Uninterruptible poëer supplies; automat ABB; FV VDF inverter për pompa; FV pajisje lëshimi komandimi për elektropompe; FV elektromotori; furnizim me elektropompe, furnizim me elektropompe; furnizim invertera pompa; me përshkrimin e mallit Furnizim soft starter, pompe zhytëse; bazamneti i montimit anesor; FV soft starter; pompe centrifugale uji; pompe zhytëse uji; panel lëshimi; Për më tepër, referuar edhe pohimit të autoritetit kontraktor se: *“operatori ekonomik i shpallur fitues ka paraqitur dokumentacion që provon realizimin e një sërë furnizimesh të ngjashme me natyrë teknike të krahasueshme, ndër të cilat përfshihen furnizime me pajisje elektromekanike, pompa industriale, panele elektrike dhe komponentë të sistemeve teknologjike. Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton, ndër të tjera, furnizimi me pajisje teknike dhe elektromekanike si elektropompa industriale, inverterë dhe panele elektrike të kontrollit, të cilat janë komponentë tipikë të sistemeve të automatizimit dhe kontrollit industrial. Po kështu, në furnizimet e realizuara përfshihen edhe sisteme dhe komponentë teknikë si panel elektrik me soft-starter, motorë elektrikë dhe pajisje të tjera elektroteknike, të cilat përbëjnë elementë thelbësorë të sistemeve teknologjike industriale. Gjithashtu, dokumentacioni i paraqitur provon realizimin e furnizimeve me pompa centrifugale, pompa zhytëse dhe panele kontrolli industriale, të cilat janë pajisje me karakteristika të ngjashme funksionale dhe teknike me pajisjet që përdoren në procese të ndryshme industriale.”*, rezulton se zërat e përmendur nga AK, në asnjërën prej tyre nuk janë të ngjashme me zërin “Makineri shtypshkimi” të objektit të prokurimit.

Komisioni gjykon, se krahasueshmëria e kontratave nëse janë të ngjashme, nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e kontratës se ajo është një kontratë mallrash dhe ky fakt mjafton, por duhet parë në

lidhje me zërat konkretë të mallrave të furnizuara. Në rastin konkret asnjë nga zërat e faturave të paraqitura nga operatori ekonomik “MUHOPLUS” LTD nuk mund të konsiderohet e ngjashme me mallin objekt - prokurimi “*makineri shtypshkrimi*”. KPP gjykon, se eksperiencat e paraqitura nga operatori ekonomik “MUHOPLUS” LTD nuk dëshmojnë se ky i fundit ka realizuar furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit në vlerën e kërkuar nga autoriteti kontraktor, duke mos krijuar kështu bindjen për realizimin me sukses të kësaj kontrate.

Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik “MUHOPLUS” LTD me dokumentacionin e paraqitur nuk provon, se ka realizuar eksperiencat të ngjashme me objektin e prokurimit dhe nuk ka plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për përvojë të suksesshme, pasi faturat elektronike të paraqitura nuk janë të ngjashme me objektin e prokurimit

Sa më sipër, KPP sqaron, se subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor, e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Pretendimet e ankimuesit qëndrojnë .

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “ për operatorin ekonomik “MUHOPLUS” LTD, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimet e mësipërme qëndrojnë, pasi operatori ekonomik “MUHOPLUS” LTD nuk përmbush kriteret e kualifikimit, lidhur me eksperiencat e mëparshme të ngjashme dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të KPP do të jetë e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshon gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të*

Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “4E-COLOR” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-67300-10-30-2025, me objekt: “*Furnizim me makineri shtypshkrimi*”, me fond limit 19 760 000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.01.2025 nga autoriteti kontraktor, Shtypshkronja e Letrave me Vlerë sh.a.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit “MUHOPLUS” LTD dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor të bëjë rivlerësim të procedurës së prokurimit në SPE, në zbatim të konstatimeve të KPP-së në këtë vendim.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera
5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “4E-COLOR” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

